



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 254

Tiranë – E premte, 30 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 891, datë 21.12.2016	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës, për heqjen e ndërsjellë të kërkesave për vizë..... 25457
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 892, datë 21.12.2016	Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit..... 25459
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 21.12.2016	Për një shtesë në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar..... 25463
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 894, datë 21.12.2016	Për dhënie ndihme financiare familjes së inspektorit Ervin Robert Haxhiu, ish-punonjës policie, i cili ka humbur jetën në krye të detyrës... 25463
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 895, datë 21.12.2016	Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin..... 25463
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 896, datë 21.12.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr.206, datë 9.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës–Kavajë nga pushtimet e Çermës, Loti III”..... 25470
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 898, datë 21.12.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës –Kavajë nga pushtimet e Çermës (Loti I)”..... 25471
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 899, datë 21.12.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 632, datë 7.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Abaz Bej Lushnja””..... 25472

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 900, datë 21.12.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 577, datë 3.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksion i rrugës “Mujo Ulqinaku” (seg. i dytë) dhe rrugës “Jakov Mile”, Fier””.....	25473
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 901, datë 21.12.2016	Për ngritjen e komisionit ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore që mund të kalojë dhe të bëhet pjesë e fondit të tokës për kompensimin e pronave.....	25474
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 902, datë 21.12.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 36, datë 16.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e anëtarëve të bordit drejtues të zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.....	25475
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016	Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë.....	25475
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 21.12.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 787, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen e komisioneve eprore të caktimit të aftësisë për punë”.....	25477
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 906, datë 21.12.2016	Për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes në ngastrat e ekonomisë pyjore “Mali i Molishtit”, të rrethit Berat, që do të përdoret nga shoqëria “Salillari” sh.p.k., për ushtrimin e aktivitetit minerar në shfrytëzimin e mineralit të gurit gëlqeror.....	25478
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 907, datë 21.12.2016	Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve.....	25479
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 908, datë 21.12.2016	Për përcaktimin e masave për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime.....	25484
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 909, datë 21.12.2016	Për rikuperimin e avujve të benzinës në fazën e dytë, gjatë mbushjes së mjeteve motorike në stacionet e shitjes së karburanteve.....	25498
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 910, datë 21.12.2016	Për çështjet, objekt konsultimi, dhe stukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore.....	25500
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 911, datë 21.12.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.555, datë 11.8.2011, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të Infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar	25504
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 912, datë 21.12.2016	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror Dom Ernest Simoni Troshani.....	25505

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 913, datë 21.12.2016	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror znj. Edith Mihali.....	25506
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 21.12.2016	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Lulzim Balla.....	25506
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 915, datë 21.12.2016	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Lionel Konomi.....	25506
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 916, datë 21.12.2016	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Enver Shengjergji	25506
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 917, datë 21.12.2016	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Zef Dedë.....	25507
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 918, datë 21.12.2016	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Kujtim Gjonaj.....	25507
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 919, datë 21.12.2016	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Çapajev Gjokutaj...	25507
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 920, datë 21.12.2016	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Sabah Bizi.....	25507
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 921, datë 21.12.2016	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Ramadan Rragami	25508
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 922, datë 21.12.2016	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Paulin Ndoja.....	25508
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 923, datë 21.12.2016	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Ilir Pernaska.....	25508
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 924, datë 21.12.2016	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Alfred Serreqi.....	25508
Kërkesë e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 6195, datë 21.12.2016	Për shpronësim për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ura e Matit (shtesa)”, për pasuritë e llojit “drufrutorë”.....	25509

**VENDIM****Nr. 891, datë 21.12.2016****PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË
MINISTRAVE TË UKRAINËS, PËR
HEQJEN E NDËRSJELLË TË
KËRKESAVE PËR VIZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës, për heqjen e ndërsjellë të kërkesave për vizë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

MARRËVESHJE**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KABINETIT TË MINISTRAVE TË
UKRAINËS PËR HEQJEN E NDËRSJELLË
TË KËRKESAVE PËR VIZË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Kabineti i Ministrave të Ukrainës (në vijim referuar si “Palët Kontraktuese”),

Me dëshirën për të forcuar miqësinë dhe bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ukrainës,

Me qëllim që të lehtësojnë formalitetet e udhëtimit për shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe të Ukrainës.

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e shteteve të Palëve kontraktuese që mbajnë dokumente të vlefshme udhëtimi të listuara në aneksin e kësaj marrëveshjeje do të hyjnë,

qëndrojnë, dalin dhe kalojnë transit përmes territorit të vendit të palës tjetër kontraktuese pa viza, me kusht që kohëzgjatja e qëndrimit të tyre të mos tejkalojë 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë.

Neni 2

Shtetasit e shteteve të palëve kontraktuese, që kanë ndërmend të hyjnë në territorin e vendit të palës tjetër kontraktuese për një periudhë që tejkalon 90 (nëntëdhjetë) ditë, pavarësisht nga qëllimi i udhëtimit, do të marrin vizë në misionin diplomatik apo postin konsullor të vendit të palës tjetër kontraktuese përpara hyrjes në territorin e saj.

Neni 3

1. Shtetasit e shteteve të palëve kontraktuese, në rast të humbjes ose dëmtimit të dokumenteve të vlefshme të udhëtimit të listuara në aneksin e kësaj marrëveshjeje gjatë qëndrimit në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese, njoftojnë menjëherë autoritetet kompetente të këtij vendi, i cili, në këtë rast do të lëshojë një certifikatë që pranon marrjen e njoftimit për humbjen e dokumentit në fjalë.

2. Misionet diplomatike ose postet konsullore të vendeve të palëve kontraktuese do të pajisin personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni me një dokument të vlefshëm udhëtimi për kthim në territorin e vendit të palës kontraktuese përkatëse.

Neni 4

Shtetasit e shteteve të palëve kontraktuese që mbajnë dokumente të vlefshme udhëtimi të listuara në aneksin e kësaj marrëveshjeje do të hyjnë, dalin dhe kalojnë transit nëpër territorin e vendit të palës tjetër kontraktuese, përmes pikave kufitare sipas ligjit të vendeve të palëve kontraktuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje nuk përjashton personat e përmendur në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje nga detyrimi për të respektuar legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe të Ukrainës, gjatë qëndrimit në territoret e tyre.

Neni 6

Secila palë kontraktuese rezervon të drejtën të refuzojë hyrjen, të redukojë periudhën e qëndrimit



ose të përfundojë qëndrimin në territorin e saj lidhur me personat e përmendur në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje të njohur si “*persona nongrata*” ose të papranueshëm apo që rrezikojnë rendin publik, shëndetin publik ose sigurinë publike.

Neni 7

1. Palët kontraktuese do të shkëmbejnë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, specimene të dokumenteve të vlefshme të udhëtimit të listuara në aneksin e kësaj marrëveshjeje, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas datës së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

2. Në rastin e futjes në prodhim të dokumenteve të reja të udhëtimit të renditura në aneksin e kësaj marrëveshjeje ose të çdo ndryshimi në ato të vlefshme, palët kontraktuese do të njoftojnë menjëherë për këtë njëra-tjetrën dhe do të shkëmbejnë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, ekzemplarë të këtyre dokumenteve udhëtimi jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para hyrjes së tyre në fuqi.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet palëve kontraktuese nga interpretimi ose zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave.

Neni 9

1. Secila palë kontraktuese mund ta pezullojë tërësisht ose pjesërisht këtë marrëveshje për shkaqe të sigurisë publike, mbrojtjes së rendit publik apo shëndetit publik. Vendimi për pezullimin e njoftohet, nëpërmjet kanaleve diplomatike, palës tjetër kontraktuese, jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë për para një pezullimi të tillë.

2. Pala kontraktuese, e cila vendos të pezullojë zbatimin e kësaj marrëveshjeje për arsyt e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të informojë në të njëjtën mënyrë palën tjetër kontraktuese në lidhje me përtëritjen e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 10

1. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe do të hyjë në fuqi në ditën e 30 (tridhjetë) nga data e marrjes, nëpërmjet kanaleve diplomatike, të njoftimit të fundit me shkrim që

konfirmon se procedurat e brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, janë plotësuar nga palët kontraktuese.

2. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin reciprok me shkrim të palëve kontraktuese. Çdo ndryshim apo shtesë e rënë dakord nga palët kontraktuese do të jetë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Secila palë kontraktuese mund ta përfundojë këtë marrëveshje duke i dërguar njoftim me shkrim palës tjetër kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, përfundimi do të hyjë në fuqi ditën e 90 (nëntëdhjetë) pas datës së marrjes së njoftimit në fjalë nga ana e palës tjetër kontraktuese.

Bërë në Tiranë, më 4.11.2016, në dy origjinalë, secili në gjuhën shqipe, ukrainase dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë autentike. Në rast mospërputhjes në interpretim të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

ANEKS

I MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS MBI HEQJEN E NDËRSJELLË TË KËRKESAVE PËR VIZË

Lista e dokumenteve të udhëtimit të lëshuara shtetasve të Republikës së Shqipërisë për hyrje, dalje, kalim transit dhe qëndrim në territorin e Ukrainës:

- Pasaporta e Republikës së Shqipërisë;
- Dokumenti i identifikimit të detarëve (Pasaporta e Detarit, sipas listës së regjistrimit të personave në bordin e anijes ose një ekstrakt i saj);
- Dokumenti i udhëtimit për kthim në Republikën e Shqipërisë (vetëm për kthim në Republikën e Shqipërisë).

Lista e dokumenteve të udhëtimit të lëshuara për shtetasit e Ukrainës për hyrje, dalje, kalim transit dhe qëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë:

- Pasaportë e shtetasit të Ukrainës për udhëtim jashtë vendit;
- Dokumenti i identifikimit të detarëve (sipas listës së regjistrimit të personave në bordin e anijes ose një ekstrakt i saj);



- Certifikatë për kthim në Ukrainë (vetëm për kthim në Ukrainë).

VENDIM

Nr. 892, datë 21.12.2016

PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE DHE KATEGORIZIMI PËR GRADAT NË POLICINË E SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 61, të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Funkcionet korresponduese dhe kategorizimi për çdo gradë, në Policinë e Shtetit, përcaktohen në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Studenti që përfundon arsimin e lartë policor në një institucion jashtë vendit, të barasvlershëm me Akademinë e Sigurisë, sipas marrëveshjeve të lidhura me shtetin ku studentët kanë përfunduar arsimin, si dhe kanë kryer njohjen dhe njehsimin e diplomave në Republikën e Shqipërisë, konform përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë, në momentin e emërimit për herë të parë në

detyrë i jepet grada “Nënkomisar” dhe i nënshtrohen trajnimit në Akademinë e Sigurisë.

3. Punonjësit e Policisë së Shtetit, të emëruar në bazë të vendimit nr. 917, datë 4.10.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 803, datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre’”, të ndryshuar, në funksione të njëjta apo të barasvlershme me ato të parashikuara në këtë vendim, vazhdojnë të qëndrojnë në këto detyra, duke mbajtur gradën ekzistuese për një periudhë deri në 1 vit. Nëse gjatë kësaj periudhe këta punonjës nuk fitojnë gradën korresponduese të funksionit që mbajnë, emërohen në një funksion tjetër, në përputhje me gradën që kanë.

4. Vendimi nr. 803, datë 21.11.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lidhja nr. 1

TABELA E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE DHE KATEGORIZIMI PËR ÇDO GRADË

GRADAT	NUMRI LIMIT PËR GRADË	FUNKSIONET
Drejtuues Madhor	1	Drejtor i Policisë së Shtetit.
Drejtuues i Lartë	6	Zëvendësdirjtor i Policisë së Shtetit, Drejtorët e Përgjithshëm.
Drejtuues i Parë	52	A. Në strukturat e Drejtorisë së Policisë së Shtetit 1. Drejtor, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit; 2. Drejtor, në Drejtoritë e Përgjithshme. B. Në strukturat e veçanta 1. Shef Zyre, në Zyrën Ndihmëse të Drejtorit të Policisë së Shtetit; 2. Këshilltar, në Zyrën Ndihmëse të Drejtorit të Policisë së Shtetit; 3. Shef Sektori, në Drejtorinë e Studimeve Strategjike; 4. Drejtor, në Drejtorinë e Antiterrorit, në Institutin e Policisë Shkencore, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe funksione të barasvlershme me to.



		C. <u>Në Akademinë e Sigurisë</u> 1. Drejtor/Dekan; 2. Drejtor i Qendrës Kërkimore-Shkencore; 3. Përgjegjës Departamenti, në Fakultet; 4. Profesor; 5. Drejtor i Kolegjit Profesional të Lartë; 6. Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit; 7. Drejtori/Administratori dhe funksione të barasvlershme me to. D. <u>Në strukturat e Drejtorive Vendore të Policisë</u> 1. Drejtor i Drejtorive Vendore të Policisë.
Drejtues	136	A. <u>Në strukturat e Drejtorisë së Policisë së Shtetit</u> 1. Shef sektori, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe Drejtoritë e Përgjithshme; 2. Asistent i Zëvendës drejtorit të Policisë së Shtetit; 3. Asistent i Drejtorit të Përgjithshëm, në Policinë e Shtetit; 4. Oficer kontakti ndërlidhës, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe funksione të barasvlershme me to. B. <u>Në struktura e veçanta</u> 1. Komandant i Repartit Special "RENEA"; 2. Specialist koordinator, në Drejtorinë e Studimeve Strategjike; 3. Drejtor i Qendrës së Mbyllur të të Huajve të Kufirit dhe Migracionit; 4. Shef Sektori në Drejtorinë e Antiterrorit, në Institutin e Policisë Shkencore, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe funksione të barasvlershme me to. C. <u>Në Akademinë e Sigurisë</u> 1. Drejtor i Certifikimeve dhe Shërbimeve ndaj të Tretëve; 2. Lektorë në Fakultet; 3. Shef Sektori i Planifikimit dhe Kurrikulave; 4. Përgjegjës Departamenti ai zëvendës drejtor, në Kolegjin Profesional të Lartë dhe funksione të barasvlershme me to. 5. <u>Në Drejtoritë vendore të Policisë</u> 1. Drejtor i Drejtorive Vendore, të Policisë Kufitare dhe Migracionit; 2. Zëvendës drejtor, në Drejtoritë Vendore të Policisë.
Kryekomisar	454	A. <u>Në strukturat e Drejtorisë së Policisë së Shtetit</u> 1. Specialist, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe Drejtoritë e Përgjithshme; 2. Shef sektori për përgjimin e telekomunikimit, në Drejtorinë e Përgjithshme për hetimin e krimit të organizuar dhe krimet e renda; 3. Shef sektori i shërbimeve të policisë gjyqësore pranë P.K.R., në Drejtorinë e Përgjithshme për hetimin e krimit të organizuar dhe krimet e renda; 4. Specialist koordinator, në Sektorin (zyra) Qendrore Kombëtare INTERPOL, EUROPOL; 5. Shef Qendre/Koordinator institucional, në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), në Drejtorinë e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin dhe funksione të barasvlershme me to. B. <u>Në strukturat e veçanta të policisë.</u> 1. Komandant i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë; 2. Shef i Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë; 3. Shef sektori në Repartin Special "RENEA"; 4. Komandant i Repartit Special, të Kufirit dhe Migracionit "DELTA"; 5. Komandanti i Repartit Special "RESI"; 6. Shef njësie/specialist në Njësinë Speciale të Antieksplozivave dhe në Njësinë Speciale të Negocimit; 7. Komandant i Repartit të Sigurisë së Brendshme dhe Ceremonialit; 8. Specialist koordinator me SHISH, specialist drejtimi, specialist në sektorin e analizës dhe kartotekës, shef njësie për tendencat e radikalizmit dhe ekstremizmit dhe shef i njësisë operacionale antiterrorizëm, në Drejtorinë e Antiterrorit; 9. Specialist, në Drejtorinë e Antiterrorit, në Institutin e Policisë Shkencore, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe funksione të barasvlershme me to.



		C. <u>Në Akademinë e Sigurisë</u> 1. Asistent lektorë në Fakultet dhe Qendrën e Kërkimeve Shkencore; 2. Përgjegjës Departamenti në Kolegjin Profesional të Lartë; 3. Shef Sektori i Trajnimit në Terren, në Kolegjin Profesional të Lartë; 4. Shef Sektori në Drejtorinë e Certifikimeve dhe Shërbimeve ndaj të Tretëve; 5. Shef Sektori i Burimeve Njerëzore; 6. Shef Sektori i Menaxhimit dhe Kontrollit; 7. Specialist për Kontrollin në Fakultet; 8. Specialist për Planifikimin dhe Kurikulën, në Sektorin e Planifikimit dhe Kurikulave; 9. Specialist për Marrëdhëniet me Jashtë, Cepol dhe funksione të barasvlershme me to. B. <u>Në strukturat e Drejtorive vendore të Policisë</u> 1. Shef sektori në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe Drejtoritë Vendore të Kufirit e Migracionit; 2. Specialist asistent, në Drejtoritë Vendore të Policisë; 3. Shef Komisariati, në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe në ato të Kufirit dhe Migracionit me personel mbi 36 punonjës dhe funksione të barasvlershme me to.
Komisar	536	A. <u>Në Drejtorinë e Policisë së Shtetit</u> 1. Specialist në sektorin për përgjimin e telekomunikimin; 2. Specialist në sektorin e shërbimeve të policisë gjyqësore pranë P.K.R. 3. Specialist, specialist për kërkimin, në Sektorin (zyra) Qendrore Kombëtare INTERPOL; 4. Specialist, në Sektorin e Bashkëpunimit, Koordinimit Ndërkombëtar dhe Përkthimeve, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit; 5. Specialist për Syberworks, në Sektorin e Trajnimit dhe Përgatitjes, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore; 6. Koordinator institucional/specialist, në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), në Drejtorinë e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin dhe funksione të barasvlershme me to. B. <u>Në strukturat e veçanta të policisë.</u> 1. Shef Seksioni, komandant njësie, në Repartin Special “RENEA”, në Repartet Speciale, në Repartet e Ndërhyrjes së Shpejtë; 2. Shef i Seksionit të Burimeve Njerëzore, në Repartet e Njësitë Speciale, Repartet e Ndërhyrjes së Shpejtë; 3. Specialist koordinator ai zëvendëskomandant, specialist i trajnimeve dhe masave mbrojtëse, Shef i Njësisë Operacionale, në Repartin Special “REST”; 4. Zëvendëskomandant, Shef seksioni, në Repartin Special të Kufirit dhe Migracionit “DELTA”; 5. Shef i Qendrës së Drejtimit dhe Menaxhimit të Operacioneve Speciale, Shef Njësie/specialist në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Përgjithshme për hetimin e krimit të organizuar dhe krimet e rënda; 6. Shef Njësie Operacionale, Shef Seksioni, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunësorëve të Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme për hetimin e krimit të organizuar dhe krimet e rënda; 7. Shef njësie në sektorët e Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale në Drejtorinë e Përgjithshme Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda; 8. Shef Seksioni dhe Shef Stacioni, në Repartin e Sigurisë së Brendshme e Ceremonialit, në Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë dhe në Qendrën e Mbyllur të të Huajve të Kufirit dhe Migracionit; 9. Specialist në Njësinë Operacionale Antiterrorizëm dhe specialist në njësitë për tendencat e radikalizmit dhe ekstremizmit, në Drejtorinë e Antiterrorit dhe funksione të barasvlershme me to. C. <u>Në Akademinë e Sigurisë</u> 1. Shef Seksioni në Kolegjin Profesional të Lartë; 2. Shef i seksionit të Sigurisë; 3. Specialist/instruktor, në Kolegjin Profesional të Lartë dhe në Drejtorinë e Certifikimeve dhe Shërbimeve ndaj të Tretëve; 4. Specialist për kontrollin e njohurive, specialist për menaxhimin e kurseve, specialist për kontrollin në kolegj, në Sektorin e Menaxhimit dhe Kontrollit dhe funksione të barasvlershme me to. D. <u>Në Drejtoritë vendore të Policisë</u> 1. Shef Komisariati, në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe në ato të Kufirit dhe Migracionit me personel deri në 36 punonjës. 2. Shef Seksioni, në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe ato të Kufirit dhe Migracionit; 3. Shef Seksioni, në Komisaritet e Policisë, në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe ato të Kufirit dhe Migracionit;



		4. Shef Stacioni, në Komisaritet e Policisë në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe në strukturat e Kufirit dhe Migracionit dhe funksione të barasvlershme me to.
Nënkomisar		A. <u>Në Drejtorinë e Policisë së Shtetit</u> 1. Oficerë të turnit, specialist, në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), në Drejtorinë e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin dhe funksione të barasvlershme me to. B. <u>Në strukturat e veçanta të policisë.</u> 1. Zëvendëskomandant njësie, Specialist, në Repartin Special “RENEA”, në Repartet Speciale, në Repartet e Ndërhyrjes së Shpejtë; 2. Zëvendës shef njësie, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme për hetimin e krimit të organizuar dhe krimet e rënda; 3. Specialist në Njësinë Speciale të Antieksplzivave dhe në Njësinë Speciale të Negocimit , 4. Specialist në Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, 5. Specialist, në Repartin Special të Kufirit dhe Migracionit “DELTA”, 6. Specialist në Qendrën e Mbyllur të të Huajve të Kufirit dhe Migracionit. 7. Specialist turni dhe Informacioni dhe funksione të barasvlershme me to. C. <u>Në Akademinë e Sigurisë</u> 1. Specialist për disiplinën, në Fakultet dhe Kolegjin Profesional të Lartë; 2. Specialist për trajnimet; 3. Përgjegjës turni dhe Informacioni dhe funksione të barasvlershme me to. D. <u>Në Drejtoritë vendore të Policisë</u> 1. Specialist, në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe Specialist në Drejtoritë Vendore Kufirit dhe Migracionit; 2. Specialist , në Komisaritet e Policisë; 3. Specialist, në Komisaritet e Kufirit dhe Migracionit; 4. Shef Poste Policie; 5. Specialist, në stacionet e Policisë;
		6. Specialist, në Seksionet dhe Stacionet e Policisë Kufitare; 7. Përgjegjës turni, në Seksionet dhe Stacionet e Policisë Kufitare dhe funksione të barasvlershme me to.
Inspektor		1. Punonjësit e policisë që përfundojnë Shkollën Bazë të Policisë; 2. Ndihmës specialist, në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit; 3. Oficer i Patrullës së Përgjithshme, në Komisaritet e Policisë; 4. Përgjegjës grupi, në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit; 5. Trupë shërbimi operacional, në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit; 6. Trupë shërbimi, në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit; 7. Komandant skuadre, në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit dhe funksione të barasvlershme me to.

**VENDIM****Nr. 893, datë 21.12.2016**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
914, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E
RREGULLAVE TË PROKURIMIT
PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 3, të nenit 76, të kreut IX, “Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, të tekstit të rregullave të prokurimit publik” bashkëlidhur vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet nënës, me këtë përmbajtje:

“objekti i tyre është furnizim me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në varësi të kërkesës së autoritetit kontraktor, të sasisë së përcaktuar të kërkuar, si dhe të çmimit të bursës, sipas Reuters, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi**

VENDIM**Nr. 894, datë 21.12.2016**

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE
FAMILJES SË INSPEKTORIT ERVIN
ROBERT HAXHIU, ISH-PUNONJËS
POLICIE, I CILI KA HUMBUR JETËN
NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, prej 5 000 000

(pesë milionë) lekësh, familjes së Inspektor Ervin Robert Haxhiu, ish-punonjës policie në Komisaratin e Policisë nr. 5, Kamzë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, i cili ka humbur jetën në krye të detyrës.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi**

VENDIM**Nr. 895, datë 21.12.2016**

**PËR KRITERET E ECURISË DHE
FITIMIT TË GRADAVE, NJËSIMIN E
FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE
PËR ÇDO GRADË, PARAQITJEN,
FORMËN DHE SPECIFIKIMET
TEKNIKE TË GRADAVE TË SHËRBIMIT
TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE
SHPËTIMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr.152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Funksionet korresponduese për çdo gradë, sipas ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, si dhe ekuivalentimi i tyre me gradat e marra sipas ligjit nr. 8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”, përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së merr gradën e nivelit bazë, që i korrespondon funksionit që kryen, vetëm nëse në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi ka vjetërsi shërbimi në strukturat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, jo më pak se:

- a) 1 muaj për gradën “Asistent zjarrfikës”, ku përfshihet edhe periudha e trajnimit për këtë gradë;
- b) 5 vjet për gradën “Zjarrfikës”;



c) 10 vjet për gradën “Kryezjarrfikës”.

3. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së merr gradën e nivelit të mesëm, që i korrespondon funksionit që kryen, vetëm nëse në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi ka vjetërsi shërbimi në strukturat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, jo më pak se:

a) 1 muaj për gradën “Inspektor zjarrfikës”, ku përfshihet edhe periudha e trajnimit;

1 muaj për gradën “Inspektor zjarrfikës”, ku përfshihet edhe periudha e trajnimit për këtë gradë;

b) 4 vjet për gradën “Kryeinspektor zjarrfikës”;

c) 6 vjet për gradën “Komisar zjarrfikës”.

6 vjet gradën “Komisar zjarrfikës”.

4. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së merr gradën e nivelit të lartë, që i korrespondon funksionit që kryen, vetëm nëse në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi ka vjetërsi shërbimi në strukturat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, jo më pak se:

a) 8 vjet për gradën “Drejtues zjarrfikës”;

b) 12 vjet për gradën “Drejtues i parë zjarrfikës”.

5. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së merr gradën e nivelit madhor, që i korrespondon funksionit të drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, vetëm nëse në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi ka vjetërsi shërbimi në strukturat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, jo më pak se 14 vjet.

6. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së, që nuk plotëson kriteret e vjetërsisë së shërbimit sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim, trajtohet me gradën paraardhëse për nivelin përkatës, për efekt të zbatimit të këtij vendimi.

7. Pas kalimit në sistemin e ri të gradave, fitimi dhe ngritja në gradën pasardhëse bëhen sipas afateve dhe kriterëve të përcaktuara në nenet 25 dhe 26, të ligjit nr.152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.

8. Paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të gradave janë përcaktuar në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Vendimi nr. 64, datë 2.2.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për inkuadrimin e gradave ushtarake në gradat e Policisë së Shtetit dhe për përcaktimin e funksioneve, që do të ushtrohen sipas tyre”, i ndryshuar, nuk zbatohet për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

10. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

Lidhja nr. 1

**TABELA E EKVIVALENTIMIT TË GRADAVE DHE E FUNKSIONEVE
KORRESPONDUESE PËR ÇDO GRADË**

GRADA SIPAS VKM-së NR. 64, DATË 2.2.2001	GRADAT EKVIVALENTE SIPAS LIGJIT NR. 152/2015	FUNKSIONET KORRESPONDUESE SIPAS STRUKTURËS AKTUALE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË MZSH-së, DHE STRUKTURËS TË MZSH-së NË NIVEL VENDOR
NIVELI MADHOR		
Drejtues i parë	Drejtues i lartë zjarrfikës	Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin
NIVELI I LARTË		
Drejtues i parë/drejtues/kryekomisar	Drejtues i parë zjarrfikës	Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin në Ministrinë e Punëve të Brendshme
Komisar/nënkomisar	Drejtues zjarrfikës	Drejtor i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor. Shef sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së
NIVELI I MESËM		
Nënkomisar/kryeinspektor	Komisar zjarrfikës	Shef sektori në drejtorinë vendore të shërbimit MZSH-së në bashkitë qendër qarku. Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së. Instruktor në Qendrën e Trajnimit Zjarrfikës



Kryeinspektor/inspektor	Kryeinspektor Zjarrfikës	Shef sektori i MZSH-së në Sektorët në nivel vendor. Drejtues për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin në Sektorët në nivel vendor . Instruktor stërvitje dhe trajnimi në Drejtorinë vendore të MZSH-së
Inspektor/nëninspektor	Inspektor zjarrfikës	Inspektor parandalimi i MZSH-se në nivel vendor
NIVELI BAZË		
Kryeasistent/asistent i parë	Krye zjarrfikës	Komandant stacioni, komandant shërbimi, punonjës në sallën operuese, instruktor stërvitje niveli bazë, mekanik
Asistent i parë/ asistent/agjent i parë	Zjarrfikës	Luftues, shpëtues, drejtues automjeti
Agjent	Asistent zjarrfikës	Punonjës i MZSH-së i nivelit bazë, pas periudhës së provës

Lidhja nr. 2

TË DHËNAT TEKNIKE TË GRADAVE TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Gradat e shërbimit të MZSH-së janë të ndara në dy grupe: në grada të mëdha spaleti dhe grada të vogla gjoksi.

Format e gradave të mëdha spaleti, për të gjitha nivelet paraqiten në një tekstil ngjyrë blu të errët të përforcuar nga brenda me një shtresë klorur polivinili (PVC), të palosur në formë trapezi (tubolare). Perimetri i trapezit është i rrethuar (konturohet) nga një kornizë/shirit plastik me ngjyrë të kuqe, i punuar artistikisht në relief.

Në brendësi të shiritit rrethues janë vendosur, në varësi të nivelit të gradës, elementet në relief në material plastik si shirit plastik drejtkëndësh, shirit plastik me motive, yjet me dimensione të ndryshme, shenja e flakës, të cilat janë të punuara artistikisht në relief, imitim qëndisje, me ngjyrë të artë.

Vendosja e elementeve në bazë të teknologjisë dhe punimit bëhet me stampim, në të nxehtë dhe në presion, të elementeve plastike. Ngjitja e elementeve të veçanta të plastikës duhet të jetë uniform dhe homogjen për të siguruar rezistencën maksimale nga shqitja.

Të gjitha elementet plastike janë në metalizim me fletë metalike të artë duke ruajtur efektin e punimeve të imta që kërkon modeli, ashtu edhe shkëlqimin e ngjyrave. Pas kësaj, elementet plastike mbrohen nga një fletë plastike e tejdukshme e ngjitur në mënyrë organike me elementet për ta ruajtur kështu nga oksidimet eventuale si rrjedhojë e faktorëve atmosferikë.

Gradat e mëdha spaleti, për vetë pozicionin e tyre, janë në formë tubolare dhe me pamje të sipërme trapezoidale. Konkretisht, për gradat “Asistent zjarrfikës” deri në gradat “Drejtues i parë

zjarrfikës”, dimensionet janë 60 mm x 58 mm dhe me gjatësi 90 mm, ndërsa për gradat “Drejtues i lartë zjarrfikës” gjatësia shkon 105 mm. Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementeve të gradave është +/-1mm.

Lënda e parë (materiali) që do të përdoret është tekstil ngjyrë blu i errët, përzierja; 67% pambuk -33 % fibër poliestër +/-3%. Pesha e tekstilit 125 g/m² +/-5 g.

Gradat e vogla të gjoksit janë në formë drejtkëndëshi me dimensione të jashtme të unifikuara prej 86 mm x 30 mm. Toleranca e dimensionit apo pozicionimit të elementeve të gradave është +/-1mm.


Gradat e gjoksit në pjesën e pasme kanë të qepur në mënyrë solide një material me efekt ngjitës (velkrof-ana mashkull) që e bën gradën të jetë e çmontueshme nga velkroffemër që është e qepur në objektet e uniformës.

Gradat janë realizuar me material plastik, me bazë PVC, me termofiksion dhe me shtresë mbrojtëse nga përpara. Baza është me fushë ngjyrë blu të errët me dimensione; gjatësi 82 mm, gjerësi 26 mm. Në pjesën e brendshme të gradës, në brendësi të shiritit rrethues janë vendosur, në varësi të nivelit të gradës, elementet në relief në material plastik të punuara artistikisht në relief, imitim qëndisje me ngjyrë të artë. Janë të ndërtuara nga një kornizë perimetrale 2,5–3 mm në ngjyrë të kuqe. Drejtkëndëshi është i përbërë nga një masë e mjaftueshme plastike, e punuar në të nxehtë, në stampën e cila paraqet në relief formën e gradës, të përfshira brenda kornizës.

E gjithë grada është e veshur për mbrojtje me një fletë plastike transparente, në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen nga proceset e oksidimit që vijnë nga agjentët atmosferikë.

PARAQITJA, FORMA E GRADAVE TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË MZSH-së


Gradë spaleti për “Asistent zjarrfikës”



Gradë gjoksi për “Asistent zjarrfikës”



Gradë spaleti “Zjarrfikës”



Grada e vogël gjoksi “Zjarrfikës”




Gradë spaleti gjoksi “Kryezjarrfikës”



Gradë e vogël gjoksi “Kryezjarrfikës”




Gradë spaleti “Inspektor zjarrfikës”



Gradë e vogël gjoksi “Inspektor zjarrfikës”



Gradë spaleti “Kryeinspektor zjarrfikës”



Gradë e vogël gjoksi “Kryeinspektor zjarrfikës”




Gradë spaleti “Komisar zjarrfikës”



Gradë e vogël gjoksi “Komisar zjarrfikës”



Gradë spaleti “Drejtues zjarrfikës”



Gradë e vogël gjoksi “Drejtues zjarrfikës”



Gradë spaleti “Drejtues i parë zjarrfikës”



Gradë e vogël gjoksi “Drejtues i parë zjarrfikës”



Gradë spaleti “Drejtues i lartë zjarrfikës”



Gradë e vogël gjoksi “Drejtues i lartë zjarrfikës”



VENDIM

Nr. 896, datë 21.12.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.206, DATË 9.4.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “FURNIZIMI ME UJË I PLAZHEVE DURRËS-KAVAJË NGA PUSHPIMET E ÇERMËS, LOTI III”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.206, datë 9.4.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 3, 4, 5 dhe 6 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë “arë”, me sipërfaqe 5003.5 “pesë mijë e tre pikë pesë) m², me vlerë 1 696 186.5 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë pesë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës-Kanalizimeve.

5. Vlera e përgjithshme, prej 1 696 186.5 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2016, zëri “investime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, për programin “Furnizimi me ujë dhe kanalizime, zëri “Shpronësim” për objektet buxhetore, me kod projekti M063141.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 5, të këtij vendimi.”

2. Në tabelën e të shpronësuarve, bashkëlidhur vendimit, të dhënat ndryshohen sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË VKM-në NR. 206, DATË 9.4.2014, PAS NDRYSHIMEVE PÛRKATËSE TË SIPËRFAQEVE

Nr.	Emri	Mbiemri	Z.K.	Nr. i pasurisë	Arë			Vlera totale (lekë)	Shënime
					sip.shp.(m ²)	çmimi (lekë/m ²)	vlera (lekë)		
1	Sabri	Kacmolli	1031	119/11	2229	339	755631	755631	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Ramazan	Kacmolli	1031	119/14	2774.5	339	940555.5	940555.5	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Shuma:				5003.5			1696186.5	

VENDIM

Nr. 898, datë 21.12.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “FURNIZIMI ME UJËI PLAZHEVE DURRËS-KAVAJË NGA PUSHPIMET E ÇERMËS (LOTI 1)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr.8561, datë.22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës-Kavajë nga pusshpimet e Çermës (loti 1)”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës- Kanalizimeve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 1 752 912 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë) lekë.

4. Vlera përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “arë”, prej 1 752 912 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i investimeve të vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime për objektet buxhetore”, për programin furnizimi me ujë dhe kanalizime, me kod projekti M063141.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve.

6. Likuidimi i pronarëve do të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6, dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së trupit të



rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIME
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA PROJEKTI “FURNIZIMI ME UJË I PLAZHEVE DURRËS - KAVAJË NGA PUSHPIMET E ÇERMËS (LOTI I)”

Nr.	PRONARI			Z.K.	Nr. pas	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja e shpronësimit (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Shënime
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI							
1	Hamid	Ismail	Karaboja	2291	8/4.	arë	3082	329	1013978	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Fatmir	Shefik	Belba	2291	8/6.	arë	111	329	36519	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Sherbet	Ago	Alliu	2291	8/10.	arë	1000	329	329000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Sherbet	Ago	Alliu	2291	8/11.	arë	500	329	164500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Aishe	Fadil	Hoxha	2291	8/12.	arë	500	329	164500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Ferdinand	Dukalt	Godo	2291	45/14	arë	135	329	44415	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Shuma totale						5328		1752912	

VENDIM

Nr. 899, datë 21.12.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR.632, DATË 7.9.2016, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “ABAZ BEJ LUSHNJA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 632, datë 7.9.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Këshilli i Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

1. Lista e pasurive të prekura ndryshohet sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme të shpronësimit 10 969 849.29 (dhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e dyzet e nëntë pikë njëzet e nëntë) lekë.”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 10 969 849.29 (dhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e dyzet e nëntë pikë njëzet e nëntë) lekësh, të përballlohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



PËR DISA NDRYSHIME NË VKM-në 632, DATË 7.9.2016 TË PROJEKTTT “ABAZ BEJ LUSHNJA”

Nr.	Pronari		ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i ndërtimit	Sipërfaqja		Çmimi		Vlera		Vlera gjithsej Truall + Ndërtësë	Shënime
	Emër	Mbiemër				Truall m ²	Ndërtësë m ²	Truall lekë	Ndërtësë lekë	Truall lekë	Ndërtësë lekë		
1	Nuri	Beqiri	8571	18/136+1-1-2-3	Banesë	0	292		36005.227	0	10513526	10,513,526.3	Konfirmuar nr. 4941/1 prot, datë 15.6.2016
2	Nuri	Beqiri+ Bashk	8571	18/180	Truall	47	0	9709	0	456323	0	456323	Konfirmuar nr. 4941/1 prot, datë 15.6.2016
Shuma Total												10969849.29	

VENDIM
Nr. 900, datë 21.12.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 577, DATË 3.8.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “RIKONSTRUKSION I RRUGËS “MUJO ULQINAKU” (SEG. I DYTË) DHE RRUGËS “JAKOV MILE”, FIER””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr.8561, datë

22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 577, datë 3.8.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhet ky ndryshim:

- Numri rendor 2 i tabelës, që i bashkëlidhet vendimit në fuqi, ndryshohet, si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e përgj. Trualli m ²	Sip. e prekur trualli m ²	Çmimi për truallin lekë/m ²	Vlera e truallit lekë	Vlera e përgj. lekë	Gjendja juridike e pasurisë
2	Kostandin Jani Boçova, Leonora Jani Shkurta, Theodhor Jani Boçova, Zhaneta Jani Mone, Virgjina Jani Petani, Sofie Jani Kule, Vasillaq Jani Boçova, Arsino Jani Boçova.	8533	7/929	410	10	11,026	110,260	110,260	Konfirmuar nga ZVRPP-ja

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**VENDIM****Nr. 901, datë 21.12.2016****PËR NGRITJEN E KOMISIONIT
NDËRINSTITUCIONAL PËR
IDENTIFIKIMIN E PRONËS
SHTETËRORE QË MUND TË KALOJË
DHE TË BËHET PJESË E FONDIT TË
TOKËS PËR KOMPENSIMIN E
PRONAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 26, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit Ndërinstitucional për bashkërendimin e punës për identifikimin e pronës shtetërore që mund të kalojë dhe të bëhet pjesë e fondit për kompensimin e pronave.

2. Komisioni Ndërinstitucional kryesohet nga Zëvendëskryeministri, me përfaqësim nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit. Niveli i përfaqësimit në Komision është të paktën në nivel zëvendësministri.

3. Komisioni Ndërinstitucional ka këto përgjegjësi dhe detyra:

a) I kërkon institucioneve shtetërore vënien në dispozicion të të gjitha informacioneve për pronat, pjesë e listës së inventarit të tyre, si dhe për pronat që janë nxjerrë jashtë funksionit;

b) Identifikon pronat që mund të kalojnë në fondin e tokës;

c) Kërkon nga institucionet shtetërore përkatëse verifikimin e pronave shtetërore që mund të kalojnë në fondin e tokës për kompensim fizik;

ç) I propozon Këshillit të Ministrave kalimin e pronës shtetërore të identifikuar dhe të verifikuar në fondin e tokës.

4. Komisioni Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore mbledhet një herë në muaj, ose në çdo kohë, me kërkesë të kryetarit.

5. Në mbledhjet e Komisionit Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore, mund të

ftohen të marrin pjesë përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore dhe institucioneve të tjera të interesuara, kur çmohet se pjesëmarrja e tyre është e vlefshme për përmbushjen e detyrimeve të Komisionit.

6. Kryetari i Komisionit Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore, i raporton Kryeministrit për ecurinë e realizimit të punës së Komisionit të ngritur, problematikat e hasura, masat e ndërmarra dhe rezultatet konkrete të arritura.

7. Komisioni Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore mbështetet nga Agjencia e Trajtimit të Pronës (ATP), në rolin e sekretariatit teknik. ATP-ja ka këto detyra kryesore:

a) Përgatitjen e takimeve të këtij Komisioni;

b) Raportimin periodik në mbledhjet e këtij Komisioni, mbi realizimin e detyrave të përcaktuara në mbledhjet e mëparshme;

c) Bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për zbatimin e detyrave të këtij Komisioni;

ç) Monitorimin e zbatimit të detyrave të Komisionit;

d) Kryerjen e detyrave që përcaktohen nga kryetari i Komisionit.

8. Të gjitha institucionet e përfshira në këtë proces dhe ato të cilave do t’u kërkohej informacion dhe bashkëpunim nga ana e Komisionit, detyrohen të përgjigjen brenda afateve të kërkuara nga Komisioni. Në rast mosbashkëpunimi, brenda afateve të përcaktuara, i raportohet me shkrim kabinetit të Kryeministrit për marrjen e masave përkatëse, si dhe të masave të referuara në ligjin nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”.

9. Ngarkohen institucionet e përfaqësuara në Komisionin Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi**

**VENDIM****Nr. 902, datë 21.12.2016****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 36, DATË 16.1.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të kreut II, të vendimit nr. 752, datë 2.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës dhe të kriterëve për caktimin e anëtarëve të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe të masës së shpërblimit të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “c”, e pikës 1, të vendimit nr. 36, datë 16.1.2013, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) znj. Juliana Hoxha, përfaqësuese e ministrit të Drejtësisë;”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe bordi drejtues i saj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi****VENDIM****Nr. 903, datë 21.12.2016****PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të

lartë në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, nenit 6, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, nenit 12, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, dhe të nenit 32, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Studentët e shkëlqyer, me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që ndjekin studimet në një program studimi të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, përfitojnë bursë në masën e parashikuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë), e përlllogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë dhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve të shkëlqyer hartohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve.

2. Për studentët e regjistruar në vitet pas të parit, notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë), e përlllogaritur si mesatare e notave të të gjitha provimeve/detyrimeve të shlyera dhe të parashikuara për programin përkatës të studimit për vitet pararendëse. Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës.



3. Bursat e studimit për studentët, të cilët kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në institucionet publike të arsimit të lartë, të shpallura të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, u shpërndahen studentëve që studiojnë në këto programe dhe institucione, sipas masës së përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Studentët që frekuentojnë këto programe studimi e përfitojnë bursën vetëm për periudhën që ndjekin studimet në fushat prioritare dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.

4. Studentëve të regjistruar në programet e ciklit të parë të studimeve në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë publik dhe që u përkasin shtresave sociale në nevojë, u akordohen bursa kur ata plotësojnë kriteret për t'u konsideruar si studentë në nevojë. Masa e përfitimit të bursës është e përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Studentë në nevojë konsiderohen:

5.1 Sipas kriterit ekonomik:

a) Studentët që ndjekin studimet në largësinë mbi 10 (dhjetë) km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike nga njësia e vetëqeverisjes vendore;

b) Secili nga studentët, i cili rezulton bashkëshort me fëmijë, dhe kur familja e tij trajtohet me ndihmë ekonomike nga njësia e vetëqeverisjes vendore;

c) Personat me aftësi të kufizuar, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punës, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.

5.2 Jashtë kriterit ekonomik:

a) Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit;

b) Studentët që kanë humbur përgjegjësinë prindërore, me vendim gjykatë të formës së prerë;

c) Studentët që janë identifikuar e trajtuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;

ç) Studentët që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

5.3 Studentët nuk përfitojnë bursë apo humbasin të drejtën e përfitimit në rast se:

a) janë ndarë nga trangu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;

ç) shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokalue;

d) nuk kanë përfunduar programin e studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij, të përcaktuar në aktin e hapjes së programit përkatës të studimit.

6. Bursat për vitet e tjera, pas vitit të parë të studimeve, rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga institucionet publike të arsimit të lartë, për çdo student që rezulton student në nevojë. Njësia e qeverisjes vendore pajis studentët me dokumentacionin ligjor që vërteton gjendjen për t'u konsideruar student në nevojë.

7. Studentët që ndjekin studimet në IAL publike në vitet e tjera, pas vitit të parë të studimeve, që nuk kanë përfituar bursë në vitin e parë akademik dhe plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 5, të këtij vendimi, mund të përfitojnë bursë brenda numrit të bursave të planifikuara dhe që administrohen nga institucionet publike të arsimit të lartë.

8. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për studentët administrohen nga institucionet publike të arsimit të lartë. Bursa përlllogaritet si shpenzim mesatar ditor për lekë në ditë (lekë/ditë) dhe paguhet çdo muaj, me kalim në numrin e llogarisë bankare të çdo studenti. Drejtuesit e njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë dërgojnë zyrtarisht, çdo muaj, pranë njësisë së financës në institucionin e arsimit të lartë, të dhënat për shlyerjen e detyrimeve për frekuentimin e programit përkatës të studimit, që rrjedhin si pasojë e regjistrimit si student në atë program studimi, për të gjithë studentët që përfitojnë bursë.

9. Ministria e Arsimit dhe Sportit, mbështetur në numrin e studentëve që ndjekin vitin e parë akademik 2016–2017, harton planin e shpërndarjes së bursave, të cilat i përcjell për vlerësim dhe miratim në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këshillat bashkiakë, mbështetur në planin e dërguar nga MAS-i, shqyrtojnë dhe miratojnë kërkesat për bursë.

10. Kopje e vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e bursave përcillet zyrtarisht pranë IAL-



ve publike dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nga njësitë e qeverisjes vendore.

11. Fondi përkatës për bursat transferohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në formën e transfertës së pakushtëzuar ose transfertës për individët të çdo IAL publike.

12. Për vitin akademik 2016–2017, Ministria e Arsimit dhe Sportit harton planin e shpërndarjes për 1 800 (një mijë e tetëqind) bursa dhe ndjek procedurat e sipërcituara. Për vitet në vijim, numri dhe plani i shpërndarjes së bursave miratohet me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

13. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave, për studentët e regjistruar në vitin e parë të studimeve për vitin akademik 2016–2017, është data 31 janar 2017. Për të gjitha kategoritë tjera të studentëve të regjistruar në vitet e tjera, pas vitit të parë të studimeve në IAL-të publike, është data 30 dhjetor 2016. Për vitet akademike në vijim, afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për të gjitha

kategoritë, për sa më sipër, është jo më vonë se muaji dhjetor i vitit përkatës akademik.

14. Vendimet e institucioneve publike të arsimit të lartë dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore për miratimin e bursave të studentëve bëhen publike nga këto institucione, nëpërmjet publikimit në faqet e tyre web, si dhe në ambientet e institucioneve përkatëse.

15. Efektet financiare për mbulimin e shpenzimeve për bursa për një vit të caktuar akademik përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për periudhat përkatëse buxhetore.

16. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, institucionet publike të arsimit të lartë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

ANEKSI 1

MASA E BURSËS PËR STUDENTËT NË IAL PUBLIKE

Nr.	Kategoritë e bursave	Totali mujor i bursës në lekë
1	Universitetet dhe shkollat e tjera të larta	
	a) Bursa për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentë në nevojë, që ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë	8 900
	b) Gjysmë bursa , akordohen për raste të veçanta për kategorinë e studentëve në nevojë, që ndjekin studimet në vitin në ciklin e parë në institucionet e arsimit të lartë publik.	4 450
2	Universiteti i Sporteve	
	a) Bursa për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentë në nevojë, që ndjekin programe studimi në fushën e edukimit fizik në të cilat parashikohet të kryhen orë praktikash sportive	9 410
	b) Gjysmë bursa , akordohen për raste të veçanta për kategorinë e studentëve në nevojë, që ndjekin studimet në vitin në ciklin e parë në institucionet e arsimit të lartë publik.	4 705

VENDIM

Nr. 904, datë 21.12.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 787, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRBËRJEN E KOMISIONEVE EPRORE TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, 2 e 3, të nenit 39/2, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me

propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Financave dhe ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 787, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, numri 22, Dr. Afrim Dangëllia, mjek psikiatër, anëtar në Komisionin Epror Psikiatri-Okulistikë, në mbështetje të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 39/3, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”,



të ndryshuar, zëvendësohet me Dr. Anila Hashorva, mjeke psikiatre në qendrën spitalore universitare “Nënë Tereza”, anëtar në Komisionin Epror Psikiatri-Okulistikë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, deri në përfundimin e afatit të anëtarit të zëvendësuar.

2. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 906, datë 21.12.2016

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË
SIPËRFAQES NË NGASTRAT E
EKONOMISË PYJORE “MALI I
MOLISHTIT”, TË RRETHIT BERAT,
QË DO TË PËRDORET NGA
SHOQËRIA “SALILLARI” SHPK PËR
USHTRIMIN E AKTIVITETIT MINERAR
NË SHFRYTËZIMIN E MINERALIT
TË GURIT GËLQEROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 16.2 ha, në ngastrat 172a, 173a, 174a dhe 175a, të ekonomisë pyjore “Mali i Molishtit”, objekt i aktivitetit minerar për shfrytëzimin e mineralit të gurit gëlqeror nga shoqëria “Salillari” sh.p.k., të hiqet nga fondi pyjor dhe kullësor publik dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Sipërfaqja, sipas ngastrave pyjore dhe kullësore, jepet në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, të produkteve të tjera pyjore e jopyjore, të sipërfaqes së hequr dhe infrastrukturës së saj, paguhen nga subjekti “Salillari” sh.p.k., në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Salillari” sh.p.k., detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në shfrytëzim sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda 5 viteve të para, të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe prej 48.6 ha fond pyjor në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me bashkinë Ura Vajgurore.

4. Bashkia Ura Vajgurore dhe shoqëria “Salillari” sh.p.k. të nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët për hapat, afatet dhe procedurat për hartimin dhe realizimin e projekteve teknike lidhur me detyrimet sipas pikës 3, të këtij vendimi.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në funksion të lidhjes së marrëveshjes me shoqërinë “Salillari” sh.p.k.

6. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqeve pyjore të identifikuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë pyjore/kullësore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit të sipërfaqes, sipas lejes mjedisore, nga shoqëria “Salillari” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet fond pyjor dhe kullësor.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, bashkia Ura Vajgurore dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN
NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
MINERAR NGA SHOQËRIA "SALILLARI" sh.p.k. në rrethin e BERATIT

QARKU BERAT

Lidhja 1

ID Prones	Ekon.Pyjore/Kullosore	Ngastra	Administrimi	Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)
BR 27 172a	Mali I Molishtit	172 a	Ministria Mjedisit	3.6
BR 27 173a	Mali I Molishtit	173 a	Ministria Mjedisit	5.9
BR 27 174a	Mali I Molishtit	174 a	Ministria Mjedisit	2.4
BR 27 175a	Mali I Molishtit	175 a	Ministria Mjedisit	4.3
GJITHSEJ				16.20

VENDIM

Nr. 907, datë 21.12.2016

**PËR KUFIZIMIN E SHKARKIMEVE TË
PËRBËRËSVE ORGANIKË TË
AVULLUESHËM NGA PËRDORIMI I
TRETËSVE ORGANIKË NË DISA
BOJËRA, LLAQE DHE PRODUKTE PËR
LUSTRIMIN E MJETEVE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të nenit 15, të ligjit nr.162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të parandalojë ose të pakësojë ndotjen e ajrit nga ozoni troposferik, që formohet nga kontributi i përbërësve organikë të avullueshëm, nëpërmjet kufizimit të përmbajtjes totale të përbërësve organikë të avullueshëm në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve.

2. Ky vendim përcakton specifikimet teknike për disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e

mjeteve, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij vendimi. Për produktet e sipërpërmendura janë gjithashtu të aplikueshme kërkesat dhe masat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve e të punonjësve, si dhe mjedisin e tyre të punës, përfshirë kërkesat që lidhen me etiketimin e këtyre produkteve.

3. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr.162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”, dhe vendimit në fuqi të Këshillit të Ministrave për masat për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime, ndërsa me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

a) “Bojëra dhe llaqe”, produktet e listuara në nënkategorinë 1 të shtojcës I të këtij vendimi, me përjashtim të aerosolëve. Këto janë veshje që përdoren në ndërtesat, finiturat dhe stukimet, si dhe në strukturat shoqëruese për qëllime mbrojtjeje, funksionimi dhe dekorimi;

b) “Përmbajtje VOC”, masa e përbërësve organikë të avullueshëm, e shprehur në gramë/litrë (g/l), në përbërje të produktit të gatshëm për përdorim. Masa e përbërësve organikë të avullueshëm në një produkt të dhënë, i cili reagon kimikisht gjatë tharjes për të formuar pjesë të veshjes nuk konsiderohet pjesë e përmbajtjes së VOC-së;

c) “Produktet për lustrimin e mjeteve”, produktet e listuara në nënkategorinë 2, të shtojcës I, këtij vendimi. Ato përdoren për lyerjen e mjeteve rrugore me motor, sipas përkufizimit në nenin 47, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

ç) “Shtresë”, një shtresë e pandërprerë që

¹ Ky vendim përafron direktivën 2004/42/CE për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm për shkak të përdorimit të tretësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve që amendon direktivën 1999/13/EC. FZ L 143, 30/04/2004 f. 0087 – 0096; të ndryshuar nga direktiva 2008/112/EC dhe 2010/79/EC dhe rregullorja 1137/2008 (Fletorja Zyrtare L 085, 29/03/1999 f. 0001–0022).



rezulton nga përdorimi i një ose më shumë veshjeve në një nënshtresë;

d) “Tretës organik”, çdo VOC i cili përdoret vetëm ose në kombinim me agjentë të tjerë për të tretur ose holluar lëndët e para, produktet ose mbetjet e materialeve. Tretësi organik përdoret edhe si agjent pastrimi për të tretur lëndët ndotëse, si shpërndarës mesatar, rregullues i viskozitetit, rregullues i tensionit sipërfaqësor, plastifikues ose si lëndë konservuese;

dh) “Veshje”, çdo përzierje, përfshirë të gjithë tretësit organikë ose përzierjet që përmbajnë tretës organikë të nevojshëm për përdorimin e tyre të përshtatshëm, e cila përdoret për të siguruar një shtresë me efekte dekoruese, mbrojtëse ose funksione të tjera në një sipërfaqe;

e) “Veshje me hollues uji (HU)”, veshjet, viskoziteti i të cilave rregullohet nga përdorimi i ujit;

ë) “Veshje me hollues tretës (HT)”, veshjet, viskoziteti i të cilave rregullohet nga përdorimi i tretësit organik;

f) “Vendosje në treg” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

4. Shtojcat e mëposhtme i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij:

a) Shtojca I “Produktet e listuara sipas nënkategorisë 1 dhe nënkategorisë 2”;

b) Shtojca II “Vlerat kufi të përmbajtjes maksimale të VOC-së për bojëra, llaqe dhe produktet për lustrimin e mjeteve”;

c) Shtojca III “Metodat analitike të testimit”.

KREU II

KËRKESAT PËR PRODUKTET QË VENDOSEN NË TREG

1. Ndalohen të vendosen në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë produktet e listuara në shtojcën I, të cilat kalojnë vlerat kufi të përmbajtjes maksimale të VOC-së, pas datave të përcaktuara në shtojcën II.

2. Për të përcaktuar përputhshmërinë e produkteve me vlerat kufi të përmbajtjes së VOC-së sipas shtojcës II, përdoren metodat analitike të testimit në përputhje me përcaktimin e shtojcës III.

3. Për produktet e përcaktuara në shtojcën I, në të cilat shtohen tretës ose përbërës të tjerë që përmbajnë tretës për ta bërë produktin të gatshëm për përdorim, vlerat kufi të përcaktuara në shtojcën

II zbatohen për përmbajtjen e VOC-së në produktin e gatshëm për përdorim.

4. Kërkesat e pikave 1 deri në 3, të këtij kreu, nuk zbatohen për tretësit organikë që përdoren në disa veprimtari dhe instalime industriale, të cilat mbulohen nga legjislacioni në fuqi për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime.

5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në raste përjashtimore, autorizon shitjen dhe blerjen në sasi të kufizuara strikte të produkteve që nuk arrijnë vlerat kufi të VOC-së, të përcaktuara në shtojcën II, vetëm për qëllime restaurimi dhe mirëmbajtjeje të ndërtesave e të mjeteve motorike me vlera muzeale kulturore dhe historike, të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për kulturën.

6. Produktet, që janë objekt i këtij vendimi, të cilat janë prodhuar përpara datave të përcaktuara në shtojcën II dhe që nuk përmbushin vlerat kufi të përmbajtjes maksimale, mund të vendosen në treg për një periudhë 12-mujore nga data kur kërkesat që zbatohen për produktin në fjalë hyjnë në fuqi sipas përcaktimit të shtojcës II.

KREU III

ETIKETIMI DHE LËVIZJA E LIRË E PRODUKTEVE

1. Kur produktet e përcaktuara në shtojcën I vendosen në treg, duhet të jenë të pajisura me etiketë. Etiketa tregon:

a) nënkategorinë e produktit dhe vlerat kufi përkatëse të VOC-së në g/l, të referuara në shtojcën II;

b) përmbajtjen maksimale të VOC-së në g/l të produktit të gatshëm për përdorim.

2. Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial në ministrinë përgjegjëse për industrinë ndalon vendosjen në treg të produkteve që janë objekt i këtij vendimi, të cilat, në kushtet kur janë të gatshme për përdorim, nuk përputhen me kërkesat e këtij vendimi.

KREU IV

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

1. Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial në ministrinë përgjegjëse për industrinë harton dhe zbaton programin e inspektimit për monitorimin e produkteve të vendosura në treg për të verifikuar përputhshmërinë me kërkesat e këtij vendimi.



2. Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial në ministrinë përgjegjëse për industrinë (ISHTI) dhe AKM-ja raportojnë në ministri përkatësisht, për:

a) rezultatet e programit të monitorimit, referuar pikës 1, të këtij kreu;

b) kategoritë dhe sasitë e produkteve të autorizuara, në përputhje me kërkesat e pikës 5, të kreut II, të këtij vendimi.

3. Dy raportet e para paraqiten 18 muaj pas datës së parashikuar për përputhshmëri me vlerat kufi të përmbajtjes të VOC-së sipas përcaktimit të shtojcës II. Raportet vijuese paraqiten çdo 5 vjet.

4. Format i për paraqitjen e të dhënave nga monitorimi miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe ministrit përgjegjës për industrinë.

5. Në rastet e konstatimit të mospërputhshmërisë, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial zbaton sanksionet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 35, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar.

KREU V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ngarkohen Ministria e Mjedisit, ministria përgjegjëse për industrinë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet juridike me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

SHTOJCA I

Nënkategoritë 1:

a) “Veshje mat për mure të brendshme dhe tavane” janë veshjet e projektuara për përdorim në mure të brendshme dhe tavane, me një shkallë shkëlqimi $\leq 25@60^\circ$.

b) “Veshje me shkëlqim për mure të brendshme dhe tavane” janë veshjet e projektuara për përdorim në mure të brendshme dhe tavane, me një shkallë shkëlqimi $>25@60^\circ$.

c) “Veshje për mure të jashtme me përbërje minerale” janë veshjet e projektuara për përdorim në mure të jashtme betoni, tulle ose stukoje;

ç) “Bojëra për lëmim dhe bllokim brenda/jashtë për dru, metal ose plastik” janë veshjet e projektuara për përdorim në pjesët e prera dhe veshjet që prodhojnë një shtresë të errët. Këto shtresa projektohen për dru, metal ose sipërfaqe plastike. Kjo nënkategori përfshin nënveshjet dhe veshjet e ndërmjetme;

d) “Bojëra lëmuese dhe ujëbllokuese për dru brenda/jashtë” janë veshjet e projektuara për përdorim në pjesët e prera, që prodhojnë një shtresë transparente ose gjysmëtransparente për dekorim dhe mbrojtje të drurit, metalit dhe plastikës. Kjo nënkategori përfshin veshje ujëbllokuese me ngjyrë të errët. Veshjet ujëbllokuese me ngjyrë të errët janë veshjet që prodhojnë një shtresë me ngjyrë të errët për dekorimin dhe mbrojtjen e drurit ndaj kushteve atmosferike, sipas përcaktimit në standardin EN 927-1, brenda kategorisë gjysmë të qëndrueshme;

dh) “Veshje ujëbllokuese për dru” është veshja ujëbllokuese, e cila, në përputhje me standardin EN 927-1:1996, ka një trashësi mesatare më pak se $5\mu\text{m}$ kur testohet në përputhje me standardin ISO 2808: 1997, metodën 5A;

e) “Astar” janë shtresa me veti mbylljeje dhe/ose bllokuese, të projektuara për përdorim në dru ose mure dhe tavane;

ë) “Astar lidhës” janë veshje të projektuara për të stabilizuar humbjen e grimcave të lëndëve ose transmetimin e vetive hidrofobike dhe/ose për mbrojtjen e drurit nga njollat blu;

f) “Veshje me një komponent me performancë të lartë” janë veshjet me performancë të lartë mbështetur në material shtresëformues. Ato janë projektuar për përdorim i cili kërkon një performancë të veçantë, të tillë si astar dhe veshje të sipërme për plastiket, veshje astar për sipërfaqe hekuri, veshje astar për metale reaktive, të tillë si zinku dhe alumini, veshje antikorrozive, veshje për dysHEME, përfshirë dysHemetë e drurit dhe çimentos, kundër grafiteve (vizatime/ mbishkrime), zjarrvones dhe standardet higjienike në industrinë ushqimore ose të pijeve ose shërbimin shëndetësor;

g) “Veshje bikomponente me performancë të lartë” janë veshjet me të njëjtin përdorim si veshjet me një komponent me performancë të lartë, por me një përbërës të dytë (p.sh. aminat terciare), të shtuar përpara përdorimit;

gj) “Veshjet shumëngjyrëshe” janë veshjet e projektuara për të dhënë efektin e dy toneve ose të



efekteve shumëngjyrëshe drejtpërdrejt nga përdorimi fillestar;

h) “Veshjet për efekt dekorues” janë veshjet e projektuara të japin efekte estetike të veçanta mbi lëndë të lyera paraprakisht, të përgatitura posaçërisht ose veshjet bazë dhe të trajtuara më pas me mjete të ndryshme gjatë periudhës së tharjes.

Nënkategoritë 2:

a) “Përgatitës dhe pastrues” janë produktet e projektuara për të hequr veshjet e vjetra dhe ndryshkun, mekanike ose kimike, ose për të siguruar një çelës për veshje të reja, ku përfshihen:

i) “produktet përgatitore” që përfshijnë dhe ato për pastrimin e pistoletave sprucuese (produkt i projektuar për pastrimin e pistoletave sprucuese dhe pajisje të tjera), pastrues boje, pastrues yndyre (përfshirë llojet antistatike për plastikë) dhe heqësit e silikonit;

ii) “parapastruesit” që janë produktet e pastrimit, të projektuara për heqjen e ndotjes sipërfaqësore gjatë parapërgatitjes për dhe përpara përdorimit të materialeve të veshjeve;

b) “Stukim/mastic” janë përbërësit e rëndë strukturorë, të projektuar për përdorim për mbushjen e papërsosmërive të thella të sipërfaqes përpara përdorimit të bazës/mbushësit;

c) “Astar” është çdo veshje që është e projektuar për përdorim në metale të zhveshura ose veshjet ekzistuese për të siguruar mbrojtje nga korrozioni përpara përdorimit të astarit sipërfaqësor, si:

i) “bazë/mbushës”, që është veshja e projektuar për përdorim menjëherë përpara përdorimit të veshjes së sipërme për qëllime rezistence ndaj korrozionit, për të siguruar ngjitjen e veshjes së sipërme dhe për të promovuar formimin e një veshjeje sipërfaqësore uniforme duke mbushur papërsosmëritë e vogla sipërfaqësore;

ii) “astar i përgjithshëm për metale” që janë veshje të projektuara për përdorim si astar, të tillë si promovuesit e ngjitësit, izolues-hermetizues, sipërfaqësor, nënveshjet, astarët plastikë, veshjet mbushëse “të njome mbi të njomë” jolëmuese dhe veshjet mbushëse me sprucim;

iii) “astar fosforik” që janë veshjet që përmbajnë të paktën 0,5 % të peshës së acidit fosforik të projektuar për përdorim të drejtpërdrejtë në sipërfaqe metalike të zhveshura për të siguruar rezistencë ndaj korrozionit dhe ngjitjes; veshjet e përdorura si astar saldues; dhe solucion zbutës për sipërfaqe të galvanizuara dhe zinku;

ç) “veshja e sipërme” është çdo veshje e pigmentuar e projektuar për t’u përdorur si një shtresë e vetme ose si bazë e një shtrese të shumëfishtë për të siguruar shkëlqim dhe qëndrueshmëri. Ajo përfshin të gjitha produktet e përfshira si veshje bazë dhe veshje transparente:

i) “veshje bazë” janë veshjet e pigmentuara të projektuara për të siguruar ngjyrën dhe çdo efekt optik të dëshiruar, por jo shkëlqim ose rezistencë sipërfaqësore të sistemit veshës;

ii) “veshje transparente” është një shtresë transparente e projektuar për të siguruar shkëlqimin përfundimtar dhe vetitë rezistente të sistemit veshës;

d) “veshje speciale” janë veshjet e projektuara për përdorim si veshje të sipërme që kërkojnë cilësi të veçanta, të tilla si efekte metalike ose perlë në një shtresë të vetme, ngjyrë të fortë me performance të lartë dhe veshjet transparente (p.sh. kundër gërvishtjes dhe veshje transparente me fluor), veshje bazë reflektuese, efekte me relief (p.sh. çekiç), antirrëshqitëse, veshje izoluese për karrocë, veshje kundër gureve, veshje për finitura të brendshme dhe aerosol.



SHTOJCA II

A. Vlerat kufi të përmbajtjes maksimale të VOC-së për bojëra dhe llaqe

	Nënkategoritë e produktit	Lloji	Faza I (g/l (*)) (nga 1.1.2020)	Faza II (g/l (*)) (nga 1.1.2023)
A	Mure të brendshme dhe tavane mat (shkëlqimi <25@60°)	HU	75	30
		HT	400	30
B	Mure të brendshme dhe tavane të shkëlqyeshme (Shkëlqimi >25@60°)	HU	150	100
		HT	400	100
C	Muret e jashtme me përbërje minerale	HU	75	40
		HT	450	430
Ç	Bojëra për lëvim dhe bllokim brenda/jashtë për dru dhe metal	HU	150	130
		HT	400	300
D	Bojëra lëmuese dhe ujëbllokuese për dru brenda/jashtë, përfshirë veshje ujëbllokuese me ngjyrë të errët	HU	150	130
		HT	500	400
DH	Veshje ujëbllokuese për dru brenda/jashtë	HU	150	130
		HT	700	700
E	Astarë	HU	50	30
		HT	450	350
Ë	Astarë lidhëse	HU	50	30
		HT	750	750
F	Veshje me një komponent me performancë të lartë	HU	140	140
		HT	600	500
G	Veshje bikomponente me performancë të lartë për përdorim specifik të tillë si dysHEME	HU	140	140
		HT	550	500
GJ	Veshje shumëngjyrëshe	HU	150	100
		HT	400	100
H	Veshje me efekt dekoruese	HU	300	200
		HT	500	200

(*) g/l gati për përdorim

**B. Vlerat kufi të përmbajtjes maksimale të VOC-së për produktet për lustrimin e mjeteve**

	Nënkategoria e produktit	Veshje	POA g/l (*) (1.1.2020)
A	Përgatitës dhe pastruese	Përgatitës Parapastrues	850 200
b	stukim/mastic	Të gjitha llojet	250
c	Astar	bazë/mbushës dhe astar i përgjithshëm për metale astar fosforik	540 780
ç	veshja e sipërme	Të gjitha llojet	420
d	veshje speciale	Të gjitha llojet	840

(*) g/l të produktit të gatshëm për përdorim. Me përjashtim të nënkategorisë “a” çdo përmbajtje uji e produktit të gatshëm për përdorim duhet zbritur.

SHTOJCA III**Metodat analitike të testimit, referuar në kreun II, pika 2**

Parametri	Njësi	Test	
		Metoda	Data e publikimit
Përmbajtja e VOC-së	g/l	ISO 11890-2	2002
Përmbajtja e VOC-së kur janë të pranishëm holluesit reagues	g/l	ASTMD 2369	2003

VENDIM**Nr. 908, datë 21.12.2016**

**PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR
KUFIZIMIN E SHKARKIMIT TË
PËRBËRËSVE ORGANIKË TË
AVULLUESHËM NGA PËRDORIMI I
TRETËSVE ORGANIKË NË DISA
VEPRIMTARI DHE INSTALIME²**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të nenit 15, të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Qëllimi i këtij vendimi është të parandalojë ose të pakësojë efektet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm në mjedis, kryesisht në ajër, dhe rreziqet potenciale në shëndetin e njeriut, duke përcaktuar vlerat kufi për këto komponime, si dhe duke parashikuar masa e procedura për t'u zbatuar për disa veprimtari që përdorin tretës organikë.

2. Ky vendim zbatohet për veprimtaritë e përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe kur këto veprimtari funksionojnë mbi pragjet e konsumimit të tretësve, sipas vlerave të caktuara në shtojcën IIA, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

² Ky vendim përaftron pjesërisht direktivën 2010/75/EU të Parlamentit dhe Këshillit të Evropës, të datës 24 nëntor 2010 mbi shkarkimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes) OJ L 334, 17.12.2010, p. 17–119 CELEX 32010L0075.



a) “Bojë”, një përzierje, përfshirë të gjithë tretësish organikë ose përzierjet me përmbajtje tretësish organikë që nevojiten për përshtatjen e përdorimit të tyre, e cila përdoret në veprimtari printimi, për të printuar tekste ose për të stampuar imazhe në një sipërfaqe të caktuar;

b) “Funksionim normal”, të gjitha periudhat e funksionimit të instalimit ose aktivitetit, me përjashtim të funksioneve të ndezjes, ndalimit dhe mirëmbajtjes së pajisjes;

c) “Funksionet e ndezjes dhe të fikjes”, operacionet që sjellin një veprimtari, pajisje ose cisternë në apo jashtë shërbimit apo në ose jashtë një gjendjeje inaktive, duke përjashtuar fazat e luhatjeve të rregullta të veprimtarisë;

ç) “Instalim”, njësia teknike e palëvizshme, në të cilën kryhen një ose më shumë nga veprimtaritë e përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe çdo lloj veprimtarie tjetër, që lidhet drejtpërdrejt me të, e cila ka lidhje teknike me veprimtaritë e kryera në atë vend dhe që mund të ketë ndikim mbi shkarkimet;

d) “Instalim ekzistues”, instalimi që është në funksionim ose instalimi i pajisur me leje mjedisi sipas legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, me kusht që instalimi të jetë vënë në funksionim jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

dh) “Instalim i ri”, instalimi që vihet në funksionim pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

e) “Input”, sasia e tretësve organikë dhe sasia e tyre në përzierjet e përdorura gjatë kryerjes së një veprimtarie, përfshirë tretësit e ricikluar brenda dhe jashtë instalimit, sasi të cilat llogariten çdo herë që ato përdoren për kryerjen e veprimtarisë;

ë) “Konsum”, inputi total i tretësve organikë në një instalim gjatë një viti kalendarik ose gjatë çdo periudhe tjetër 12-mujore, duke zbritur sasinë e VOC-eve që është rikuperuar/rigjeneruar për ripërdorim;

f) “Kushtet e mbajtjes”, kushtet në të cilat instalimi funksionon në mënyrë të tillë që VOC-et e çliruara nga veprimtaria mblidhen dhe shkarkohen në mënyrë të kontrolluar, nëpërmjet një oxhaku ose pajisje për pakësimin e shkarkimeve dhe, si pasojë, janë jo tërësisht fluruese;

g) “Kushtet standarde”, temperatura 273,15 K dhe trysnia 101,3 kPa; Vlerat kufi të shkarkimeve, të cilat janë të shprehura si përqendrimet në masë për metër kub (m³) do të llogaritet në kushte standarde.

gj) “Kategoritë M1-M3, N1-N3, O1-O3” kanë të njëjtin kuptim sipas përkufizimit në nenin 47, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

h) “Leje mjedisi e tipit A, B ose C” ka të njëjtin kuptim të dhënë në pikat 12, 13 e 14, të nenit 3, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;

i) “Llak”, një veshje transparente;

j) “Mbetje e gaztë”, shkarkimi i gaztë përfundimtar nga oxhaku ose pajisja për pakësimin e shkarkimeve në ajër, që përmban përbërës organikë të avullueshëm ose ndotës të tjerë;

k) “Ndryshim i konsiderueshëm në instalimin ekzistues”, një ndryshim i kontributit maksimal të masës së tretësve organikë në një instalim ekzistues, mesatarisht gjatë 1 dite, kur instalimi prodhon produktin e projektuar në kushte të ndryshme nga ato të ndezjes, fikjes dhe mirëmbajtjes së pajisjeve, quhet i konsiderueshëm në qoftë se ai çon në një rritje të shkarkimeve të komponimeve organike të avullueshme në më shumë se:

- 25% për një instalim që kryen ose aktivitetet, të cilat bien brenda intervalit me të ulët të pragut, sipas pikave 1, 3, 4, 5, 8, 10, 13, 16 ose 17, ose për veprimtari të tjera, që konsumojnë tretës më pak se 10 tonë/në vit, siç përcaktohet në shtojcën IIA, bashkëlidhur këtij vendimi;

- 10% për të gjitha instalimet e tjera.

l) “Ngjitës”, çdo përzierje, përfshirë të gjithë tretësish organikë ose përzierjet me përmbajtje tretësish organikë të nevojshëm për aplikimin e tyre siç duhet, i cili përdoret për ngjitjen e pjesëve të veçanta të produktit;

ll) “Operator” ka të njëjtin kuptim si në pikën 25, të nenit 3, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, të ndryshuar;

m) “Përzierje” ka të njëjtin kuptim të dhënë në pikën 1.2, të nenit 5, të ligjit nr. 27, datë 17.3.2016, “Për menaxhimin e kimikateve”;

n) “Përbërës organik”, çdo përbërës që përmban, të paktën, elementin karbon dhe një ose më shumë elemente hidrogjeni, halogjeni, oksigjeni, squfuri, fosfori, silici ose azoti, me përjashtim të oksideve të karbonit, karbonateve inorganike dhe bikarbonateve;

nj) “Përbërës organik i avullueshëm (VOC)”, çdo përbërës organik ose fraksione të katranit, që në 293,15 K ka një trysnë avulli prej 0,01 kPa ose



më shumë, ose që në kushte të veçanta përdorimi ka avullueshmëri të ngjashme;

o) “Regjistrim”, regjistrimi i instalimit ose veprimtarisë që synohet të vihet në funksionim dhe që është objekt i këtij vendimi. Regjistrimi kryhet nga ana e AKM-së ose agjencisë rajonale të mjedisit (ARM) përkatëse, mbi bazën e njoftimit të bërë nga operatori, për qëllime të futjes në punë të një instalimi;

p) “Ripërdorim”, përdorimi i tretësve organikë të rigjeneruar nga instalimi për qëllime tregtare ose teknike dhe përfshin përdorimin si karburant, por përjashton asgjësimin përfundimtar si mbetje të tretësve të tillë organikë, të rigjeneruar;

q) “Substancë”, çdo element kimik dhe përbërësit e tij, me përjashtim të substancave të mëposhtme:

i) radioaktive, siç përcaktohet në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”;

ii) mikroorganizmave të modifikuar gjenetikisht, siç përcaktohet në legjislacionin specifik kombëtar;

iii) organizmave të modifikuar gjenetikisht, siç përcaktohet në legjislacionin specifik kombëtar.

r) “Shkarkim” ka të njëjtin kuptim të dhënë në pikën 18, të nenit 5, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar;

rr) “Shkarkim flurues”, çdo shkarkim i përbërësve organikë të avullueshëm në ajër, që nuk bëhet nëpërmjet mbetjeve të gazta në ajër, tokë dhe ujë, po që se nuk është përcaktuar ndryshe në shtojcën IIA, bashkëlidhur këtij vendimi, tretësit që përmbahen në çdo produkt;

s) “Shkarkimi total”, shuma e shkarkimeve fluruese me shkarkimet e mbetjeve të gazta;

sh) “Vlera kufi e shkarkimit”, masa e përbërësve organikë të avullueshëm, e shprehur në terma të disa parametrave specifikë, përqendrim, përqindje dhe/ose nivel i shkarkimit, që nuk mund të kalojë gjatë një ose më shumë periudhave kohore;

t) “Tretës organik”, çdo VOC që përdoret:

i) vetëm ose në kombinim me agjentë të tjerë dhe pa pësuar ndonjë ndryshim kimik, për të tretur lëndë të para, produkte ose materiale mbetjeje;

ii) si agjent pastrimi për të tretur ndotës;

iii) si tretës, si mjet hollues, si rregullues i viskozitetit, si rregullues i tensionit sipërfaqësor, si plastifikues apo si veshje izoluese.

th) “Veshje”, çdo përzierje, përfshirë të gjithë tretësit organikë ose përzierjet që përmbajnë tretës

organikë të nevojshëm për aplikimin e tyre siç duhet, e cila përdoret për të dhënë efekte dekorative, mbrojtëse ose efekte të tjera funksionale mbi një sipërfaqe të caktuar.

KREU II

DETYRIMET QË ZBATOHEN PËR INSTALIMET E REJA DHE PËR ATO EKZISTUESE

1. Operatorët e instalimeve të reja marrin masat e nevojshme që instalimet e reja, që pajisen me leje mjedisi të tipit:

a) A, të përputhen me kërkesat e kërësve IV, VII dhe VIII, të këtij vendimi;

b) B dhe C, përpara vënies së tyre në funksionim, të regjistrohen përkatësisht në AKM/ARM dhe në lejet përkatëse të përcaktohen kushte që lidhen me shkarkimet e përbërësve organikë të avullueshëm, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

2. Operatorët e instalimeve ekzistuese marrin masat e nevojshme që instalimet ekzistuese:

a) të pajisura me leje mjedisi të tipit A, të jenë në përputhje me kërkesat e parashikuara në kërës IV, VII dhe VIII të këtij vendimi, jo më vonë se data 31 tetor 2024;

b) të pajisura me leje mjedisi të tipit B dhe C, të regjistrohen pranë AKM/ARM, të cila, jo më vonë se data 31 tetor 2024 rishikojnë kushtet e lejes mjedisore për VOC-të në lidhje me kërkesat e këtij vendimi;

c) përpara rishikimit të kushteve të lejes së mjedisit, të dorëzojnë pranë AKM/ARM skemën e pakësimit të shkarkimeve të parashikuar në shtojcën IIB, bashkëlidhur këtij vendimi jo më vonë se 31 tetor 2022.

3. Kur instalimi ekzistues i nënshtrohet një ndryshimi të konsiderueshëm ose bëhet objekt i këtij vendimi për herë të parë, si pasojë e një ndryshimi të konsiderueshëm, kjo pjesë e instalimit, e cila i nënshtrohet ndryshimit të konsiderueshëm, trajtohet si një instalim i ri. Ajo mund të trajtohet edhe si një instalim ekzistues, por vetëm me kushtin që shkarkimet totale të të gjithë instalimit të mos i tejkalojnë shkarkimet që mund të rezultojnë në qoftë se pjesa e ndryshuar konsiderueshëm do të ishte trajtuar si instalim i ri.

4. Operatorët e instalimeve të reja dhe ekzistuese, përveç masave të mësipërme, marrin masat e nevojshme që të gjitha instalimet të jenë në



përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, që rregullon tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore. Modifikimi, zgjerimi ose riparimi i instalimeve u nënshtrohen kërkesave të këtij kreu. Kërkesat ndaj operatorëve që disponojnë instalime mbikëqyren nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

KREU III

KËRKESAT TEKNIKE PËR INSTALIMET

1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI):

a) krijon dhe mban regjistrin e instalimeve dhe të pajisjeve, objekt i këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, dhe informon, sipas rastit, AKM/ARM-në, me kërkesë të këtyre të fundit;

b) monitoron përputhshmërinë e instalimeve me rregullat dhe standardet teknike të aplikueshme për instalimin/pajisjen, të vlerësuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të miratuara nga ministria përgjegjëse për industrinë.

2. AKM/ARM-ja përcakton në kushtet e lejeve të mjedisit kërkesa specifike, që sigurojnë që shkarkimet nga instalimet të përputhen me:

a) vlerat kufi të shkarkimit në mbetjet e gazta dhe vlerat e shkarkimeve fluruese ose vlerat kufi të shkarkimit total dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në shtojcën IIA (pjesa 1 dhe 2);

b) kërkesat e skemës së pakësimit të shkarkimeve, të përcaktuara në shtojcën IIB, me qëllim arritjen e një reduktimi ekuivalent të emetimit, në krahasim me atë që arrihet nëpërmjet aplikimit të vlerave kufi të shkarkimeve të përcaktuara në shkronjën “a”.

3. AKM/ARM, rast pas rasti:

a) për shkarkimet fluruese, si vlerë shkarkimi kufi në instalime, zbaton vlerat e shkarkimeve fluruese të përcaktuara në shtojcën IIA, bashkëlidhur këtij vendimi. AKM/ARM përjashton nga ky detyrim instalimet, për të cilat operatori provon se, megjithëse ka përdorur teknikën më të mirë të disponueshme, sipas legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit, vlera e shkarkimit kufi nuk është e mundur të arrihet, me kusht që instalimi të mos paraqesë rreziqe të konsiderueshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;

b) përjashton nga kërkesat e parashikuara në

shtojcën IIA veprimtaritë që nuk mund të funksionojnë në kushte të mbajtjes, kur kjo mundësi është përmendur qartësisht në këtë shtojcë. Veprimtari të tilla i nënshtrohen skemës së pakësimit të shkarkimeve, e parashikuar në shtojcën IIB. Në këtë rast, nëse operatori tregon se zbatimi i kësaj skeme është teknikisht dhe ekonomikisht i paralizueshëm, atëherë operatori duhet të provojë dhe të bindë AKM/ARM-në se po përdor teknikën më të mirë të disponueshme. AKM/ARM i raporton Ministrisë për përjashtimet në lidhje me shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, në përputhje me kreun VIII, të këtij vendimi.

4. Instalimet ku kryhen dy ose më shumë veprimtari, ku secila tejkalon pragjet e konsumit të tretësit, të përcaktuara në shtojcën IIA:

a) lidhur me substancat e referuara në pikën 5, plotësojnë individualisht, për secilën veprimtari, kërkesat e përcaktuara në këtë pikë;

b) lidhur me të gjithë substancat e tjera, plotësojnë individualisht, për secilën veprimtari, kërkesat e pikës 2, të këtij kreu.

Shkarkimet totale nuk i tejkalojnë shkarkimet që mund të rezultojnë po qe se zbatohet pika “b” më sipër.

5. Substancat ose përzierjet, të cilat, për shkak të përmbajtjes së VOC, në bazë të legjislacionit të posaçëm për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, klasifikohen si kancerogjene, mutagjene ose toksike për riprodhimin dhe mbajnë deklaratat e rrezikut H340, H350, H350i, H360D, ose H360F, zëvendësohen nga substanca ose përzierje më pak të dëmshme, brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme, në përputhje me udhëzimin e referuar në pikën 1, të kreut IV, të këtij vendimi.

6. Për shkarkimet e VOC-ve të referuara në pikën 5, më sipër, kur masa e prurjes së shumës së përbërësve është më e madhe ose e barabartë me 10g/orë, zbatohet vlera kufi e shkarkimit prej 2mg/Nm³. Vlera kufi e shkarkimit i referohet shumës së masës së përbërësve të veçantë.

7. Për shkarkimet e VOC-ve të halogjenizuara, të cilat mbajnë deklaratat e rrezikut H341 ose H351, kur masa e rrjedhjes së shumës të përbërësve që çon në deklaratat e rrezikut H341 ose H351 është më e madhe ose e barabartë me 100 g/orë, zbatohet vlera kufi e shkarkimit prej 20 mg/Nm³. Vlera kufi e shkarkimit i referohet masës së shumës të përbërësve të veçantë.



8. Për të minimizuar shkarkimet gjatë ndezjes dhe fikjes merren të gjitha masat paraprake të përshtatshme.

KREU IV INFORMIMI MBI ZËVENDËSIMIN E TRETËSVE ORGANIKË

1. Për çdo veprimtari që përdor tretës organikë, Ministri miraton udhëzimin për përdorimin e substancave dhe teknikave zëvendësuese, efektet negative potenciale të të cilave në ajër, ujë, tokë, ekosisteme dhe në shëndetin e njeriut janë më të ulëta se ato ekzistuese. Udhëzimi përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) përshtatshmërinë në përdorim të zëvendësuesve në dispozicion;
- b) efektet e mundshme në mjedis;
- c) pasojat ekonomike, veçanërisht kostot dhe përfitimet e opsioneve në dispozicion;
- ç) efektet e mundshme mbi shëndetin e njeriut dhe të punonjësve të ekspozuar në veçanti.

2. AKM-ja i referohet udhëzimit të parashikuar në pikën 1 të këtij kreu, gjatë përcaktimit të kushteve për lejet e mjedisit për këto aktivitete.

3. Udhëzuesi i vihet në dispozicion industrisë në fjalë dhe organizatave joqeveritare që nxisin mbrojtjen e mjedisit nga përdorimi i tretësve organikë, për zëvendësimin e mundshëm të tyre, si dhe për teknikat që kanë efekte më pak të dëmshme në ajër, ujë, tokë, ekosistemet dhe në shëndetin e njeriut.

KREU V MONITORIMI I KUSHTEVE TË LEJES SË MJEDISIT DHE SHKARKIMEVE

1. Operatori i instalimit dërgon një herë në vit në AKM ose pranë inspektoratit përgjegjës për mjedisin të dhënat që përfshijnë, të paktën,:

- a) të dhënat e monitorimit të shkarkimeve të VOC-eve, si dhe të dhëna të tjera, të përcaktuara në kushtet e lejes;
- b) një përmbledhje të rezultateve të monitorimit të shkarkimeve, që lejon një krahasim me nivelet e shkarkimit që lidhen me zbatimin e teknikave më të mira të mundshme;

2. AKM-ja verifikon nëse matjet e shkarkimeve janë kryer në përputhje me përcaktimet e shtojcës IV, bashkëlidhur të këtij vendimi.

3. Me qëllim sigurimin e përputhshmërisë, operatori:

- a) vetëmonitoron, në mënyrë të vazhdueshme:
 - i) shkarkimet e VOC-eve, kur në pikën fundore të pajisjes së pakësimit të shkarkimeve shkarkohen më shumë se mesatarja prej 10kg/orë karbon organik total;
 - ii) kanalet, me të cilat është lidhur pajisja e pakësimit të shkarkimeve.
 - b) Mat, në mënyrë të vazhdueshme ose periodike, në raste të tjera. Për matjet periodike merr, të paktën, tre lexime gjatë çdo matjeje.
4. Operatori përjashtohet nga kërkesa për të bërë matje kur pajisja e pakësimit të shkarkimeve përjashtohet nga objekti i këtij vendimi.

5. Për shkarkimet e komponimeve organike të avullueshme, të cilat mbajnë deklaratat e rrezikut H340, H350, H350i, H360D ose H360F apo komponimet organike të avullueshme, të cilat mbajnë deklaratat e rrezikut H341 ose H351, operatori kontrollon këto shkarkime nën kushtet e mbajtjes dhe vlerat e shkarkimeve nuk duhet të tejkalojnë vlerat përkatëse kufi të përcaktuara në pikat 6 e 7, të kreut III, të këtij vendimi.

6. Pajisja e pakësimit të shkarkimeve duhet të jetë e regjistruar pranë ISHTI-t dhe duhet t'i nënshtrohet, rregullisht, kontrolleve periodike nga organet e vlerësimit të konformitetit, të miratuara nga ministri përgjegjës për industrinë.

KREU VI PËRPUTHSHMËRIA ME VLERAT KUFI TË SHKARKIMIT

1. Operatori i dokumenton inspektoratit përgjegjës për mjedisin përputhshmërinë me:

- a) vlerat kufi të shkarkimit në mbetjet e gazta, vlerat e shkarkimit fluruese dhe vlerat kufi të shkarkimit total;
- b) kërkesat e skemës së pakësimit të shkarkimeve, sipas shtojcës IIB, të këtij vendimi;
- c) dispozitat e parashikuara në pikën 3, të kreut III, të këtij vendimi.

2. Udhëzime për programet e menaxhimit të tretësve që shërbejnë për të dokumentuar/demonstruar përputhshmërinë me këto parametra jepen në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Mbetjeve të gazta mund t'u shtohen vëllime gazi, për qëllime ftohjeje ose hollimi, kur një gjë e tillë justifikohet teknikisht, por nuk do të merret në konsideratë gjatë përcaktimit të përqendrimit të masës së ndotësve në mbetjet e gazta.



4. Inspektorati përgjegjës për mjedisin riverifikon përputhshmërinë në vijim të një ndryshimi të konsiderueshëm.

5. Matjet e vazhdueshme do të konsiderohen në përputhje me vlerat kufi të shkarkimit në qoftë se asnjë nga mesataret:

a) e 24 orëve të funksionimit normal nuk i kalon vlerat kufi të shkarkimit;

b) orare nuk i kalojnë vlerat kufi të shkarkimit me një faktor më të lartë se 1,5.

6. Matjet periodike do të konsiderohen në përputhje me vlerat kufi të shkarkimit në qoftë se gjatë kryerjes së një monitorimi:

a) mesatarja e të gjitha leximeve nuk i kalon vlerat kufi të shkarkimit;

b) asnjë nga mesataret orare nuk e kalon vlerën kufi të shkarkimit me një faktor më të lartë se 1,5.

7. Përputhshmëria me kërkesat e parashikuara në pikat 7 dhe 8, të kreut III, të këtij vendimi, verifikohet në bazë të shumës së përqendrimeve të masës së secilit përbërës organik të avullueshëm në fjalë. Në të gjitha rastet e tjera, përputhshmëria do të verifikohet në bazë të masës totale të karbonit organik të shkarkuar, përveçse kur është parashikuar ndryshe në shtojcën IIA, bashkëlidhur këtij vendimi.

8. Në rast të mospërputhshmërisë, operatori njofton inspektoratin përgjegjës për mjedisin dhe inspektoratin shtetëror teknik industrial (ISHTI) dhe merr masat e nevojshme për të rivendosur instalimin në kushtet e përputhshmërisë, sa më shpejt të jetë e mundur.

9. Kur mospërputhshmëria ka shkaktuar rrezik të menjëhershëm në shëndetin e njeriut dhe kur përputhshmëria nuk është arritur në kohë, në kushtet e parashikuara në pikën 8, më sipër, inspektorati përgjegjës për mjedisin pezullon funksionimin e veprimtarisë, në përputhje me kërkesat e nenit 20, të ligjit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis. ISHTI urdhëron ndalimin e funksionimit të instalimit/pajisjes në përputhje me nenin 43, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

10. Për mospërputhshmëri me kushtet e lejes së mjedisit, inspektorati përgjegjës për mjedisin zbaton kërkesat e pikës 1, të nenit 20, të ligjit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis. ISHTI, në rastet e konstatimit të mospërputhshmërisë, aplikon sanksionet e përcaktuara në ligjin nr.10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e

Shqipërisë”, në ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore në fuqi.

KREU VII SISTEMI I INFORMACIONIT DHE RAPORTIMI

1. AKM-ja përgatit çdo 3 vjet raportin për zbatimin e këtij vendimi dhe e dorëzon në Ministri brenda 9 muajve, pas përfundimit të periudhës 3-vjeçare që ai mbulon. Raporti i parë mbulon periudhën e 3 viteve të para, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, dhe përfshin të dhëna përfaqësuese për shkarkimet dhe forma të tjera të ndotjes, vlerat kufi të shkarkimit, aplikimin e teknikave më të mira në dispozicion.

2. Format i raportit të referuar në pikën 1, të këtij kreu, miratohet me urdhër të Ministrit.

3. Informacioni i paraqitur në raportin e referuar në pikën 1, të këtij kreu, përfshin, veçanërisht, të dhëna përfaqësuese të mjaftueshme për të treguar se kërkesat teknike për instalimet e parashikuara në kreun III janë plotësuar.

4. Ministria shqyrton dhe ministri miraton raportin brenda 3 muajve nga data e dorëzimit nga AKM-ja dhe e publikon në faqen elektronike të ministrisë.

KREU VIII E DREJTA E PUBLIKUT PËR TË MARRË INFORMACION DHE E PJESËMARRJES NË PROCESIN E LEJEDHËNIES

1. AKM-ja, në përputhje me legjislacionin në fuqi për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, bën të disponueshëm për publikun:

a) listën e veprimtarive të regjistruara, për të cilat është lëshuar leja e mjedisit, dhe çdo përditësim vijues;

b) legjislacionin e posaçëm të zbatueshëm për këto instalime;

c) rezultatet e monitorimit të shkarkimeve të kërkuar sipas lejes së mjedisit, të referuara në krerët V dhe VI të këtij vendimi, si pjesë e Regjistrit të Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve.

2. AKM-ja, në përputhje me legjislacionin në fuqi për miratimin e lejes mjedisore, siguron pjesëmarrjen e publikut në procedurat e:

a) dhënien së lejes për instalimet e reja;



b) dhënies së lejes për ndonjë ndryshim thelbësor.

3. Pika 1 e këtij kreu zbatohet në përputhje me legjislacionin e posaçëm për të drejtën e publikut për të marrë informacion për mjedisin dhe duke ruajtur të drejtën e konfidencialitetit të të dhënave tregtare e industriale.

KREU IX DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, agjencitë rajonale të mjedisit, inspektorati përgjegjës për mjedisin dhe Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet juridike me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

SHTOJCA I AKTIVITETET

Kjo shtojcë përmban kategoritë e veprimtarive të referuara në pikën 2, të kreut I, të këtij vendimi. Veprimtaritë e referuara në këtë shtojcë janë objekt i këtij vendimi kur funksionojnë mbi pragjet e listuara në shtojcën IIA. Në çdo rast, në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe, veprimtaria përfshin pastrimin e pajisjes por jo pastrimin e produkteve.

Veshje me adeziv/me ngjitje

- Çdo veprimtari, në të cilën një adeziv aplikohet mbi një sipërfaqe, me përjashtim të veshjeve ngjitëse dhe të laminimit, të shoqëruar me veprimtari printimi.

Veprimtari lyerje/veshje

- Çdo veprimtari, në të cilën një aplikim i vetëm ose i shumëfishtë i një shtrese të hollë të pandërprerë aplikohet si veshje në:

a) automjetet e listuara si më poshtë:

i) Makinat e reja, të përcaktuara si mjete të kategorisë M1 dhe të kategorisë N1, për sa kohë që ato janë lyer në të njëjtin instalim si mjete të kategorisë M1;

ii) Kabinën e kamionit, e përcaktuar si vendqëndrimi i shoferit dhe të gjitha pjesët ku vendosen pajisjet teknike të automjeteve të kategorisë N2 dhe N3;

Faqe | 25490

iii) Furgonë dhe kamionë, të përcaktuar si automjete të kategorisë N1, N2 dhe N3, por pa përfshirë kabinën e kamionit;

iv) autobusët, të përcaktuar si mjete të kategorisë M2 dhe M3.

b) rimorkiot, të përcaktuara në kategoritë O1, O2, O3 dhe O4;

c) sipërfaqet metalike dhe plastike, përfshirë sipërfaqet e avionëve, të anijeve, trenave etj.;

ç) sipërfaqet e drurit;

d) sipërfaqet e tekstit, pëlhurës, filmit dhe letrës;

dh) lëkurë.

Nuk përfshin lyerjen e nënshtresës me metale nga teknikat me spërkatje elektroforetike dhe kimike. Në qoftë se veprimtaria e lyerjes përfshin një hap, në të cilin i njëjti produkt është printuar duke përdorur cilëndo lloj teknike, ai hap printimi konsiderohet si pjesë e veprimtarisë së lyerjes. Megjithatë, veprimtaritë printuese, që funksionojnë si veprimtari të veçanta, nuk janë përfshirë, por mund të mbulohen nga vendimi në qoftë se veprimtaria printuese bie në fushën e zbatimit të tij.

Lyerja/veshja e bobinave

- Çdo veprimtari, ku spiralet/bobinat e çelikut, çeliku i pandryshkshëm, çeliku i veshur, aliazhet e bakrit ose shiritat e aluminit janë veshur me një shtresë të hollë ose me laminat, në një proces të pandërprerë.

Pastrimi kimik

- Çdo veprimtari industriale ose tregtare që përdor VOC-e në një instalim për të pastruar veshjet, mobiliet dhe mallra të ngjashme konsumi, me përjashtim të heqjes të njollave dhe pikave me dorë në industrinë tekstileve dhe të veshjeve.

Prodhimi i këpucëve

- Çdo veprimtari që prodhon këpucë ose pjesë të tyre.

Prodhimi i përzierjeve veshëse, llaqeve, bojërave dhe ngjitësve

- Prodhimi i produkteve përfundimtare të mësipërme, dhe i produkteve të ndërmjetme, kur kryhet në të njëjtin vend, duke përzier pigmente, rrëshirë dhe materiale ngjitëse me tretës organikë ose bartës të tjerë, përfshirë veprimtaritë e shpërndarjes dhe të parashpërndarjes, rregullimet e viskozitetit e të bojërave dhe operacionet për futjen e produktit përfundimtar në enën mbajtëse të tij.

Prodhimi i produkteve farmaceutike



- Sinteza kimike, fermentimi, ekstraktimi, formulimi dhe lustrimi i produkteve farmaceutike dhe produktet e ndërmjetme, kur prodhimi i këtyre të fundit kryhet në të njëjtin vend.

Printimi

Çdo veprimtari që riprodhon tekst dhe/ose imazhe ku, me përdorimin e një bartësi të imazhit boja transferohet në një sipërfaqe çfarëdo, përfshirë teknikat e llakimit, lyerjes/veshjes dhe laminimit që shoqërojnë atë. Megjithatë, vetëm proceset e mëposhtme janë objekt i këtij vendimi:

- Fleksografia - një veprimtari printimi që përdor një bartës imazhi prej gome ose fotopolimerielastik, mbi të cilën sipërfaqja që printohet ndodhet mbi sipërfaqen që nuk printohet, duke përdorur bojë të lëngshme, e cila thahet nëpërmjet avullimit;

Tharja e shpejtë e bojës së stampimit/printimit me anë të ajrit të nxehtë - një veprimtari printuese *web-fed*, duke përdorur një bartës imazhi në të cilën sipërfaqja e printuar dhe ajo e paprintuar janë në të njëjtin program, ku *web-fed* nënkupton që materiali për t'u printuar i vjen makinës nga një bobinë veçmas nga fletët e ndara. Sipërfaqja që nuk printohet trajtohet në mënyrë të tillë që të tërheqë ujën dhe të refuzojë bojën. Sipërfaqja që printohet trajtohet në mënyrë të tillë që të tërheqë dhe transmetojë bojën në sipërfaqen që do të printohet. Avullimi ndodh në një furrë ku, për të nxehur edhe materialin e printuar, përdoret ajër i nxehtë;

- Laminimi, që shoqëron veprimtarinë e printimit - ngjitja së bashku e dy ose më shumë materialeve flexible për të prodhuar laminate;

- Publikim rotogravurë - veprimtaria e printimit rotogravurë që përdoret për printimin e letrës për gazetatat, broshurat, katalogët ose produkte të ngjashme, duke përdorur bojëra me bazë tolueni;

- Rotogravurë - një veprimtari printimi që përdor një bartës imazhi cilindrik, në të cilin sipërfaqja ku printohet është nën sipërfaqen që nuk printohet, duke përdorur bojë të lëngshme që thahet nëpërmjet avullimit. Gropëzat janë mbushur me bojë, teprica e së cilës hiqet nga sipërfaqja që nuk printohet përpara se sipërfaqja që do të printohet të kontaktojë me cilindrin dhe të thithë bojën nga gropëzat;

- Printimi me makinë shtypi rotative - një veprimtari printimi *web-fed*, në të cilën boja kalon sipërfaqen që do të printohet duke e detyruar atë, nëpërmjet një bartësi imazhi poroz, në të cilin

sipërfaqja që do të printohet hapet dhe sipërfaqja që nuk printohet vulozet, duke përdorur bojë të lëngshme, e cila thahet vetëm nëpërmjet avullimit. *Web-fed* nënkupton që materiali që do të printohet i vjen makinës nga një bobinë veçmas nga fletët e ndara;

- Lustrimi - një veprimtari nga e cila llaku ose veshja ngjitëse aplikohet mbi një material elastik me qëllim vulosjen e mëpasme të materialit ambalazhues.

Shndërrimi i gomës

- Çdo veprimtari përzierjeje, bluarje, trazimi, kalandrimi, nxjerrje/shtrydhje dhe vullkanizimi i gomës natyrale ose sintetike dhe çdo funksion ndihmës për shndërrimin e gomës natyrale ose sintetike në produkt përfundimtar.

Pastrimi i sipërfaqeve

- Çdo veprimtari, me përjashtim të pastrimit të thatë, që përdor tretës organikë për të hequr papastërtitë nga sipërfaqja e materialit, përfshirë zgrasatimin apo heqjen e yndyrave. Veprimtaria e pastrimit, që konsiston në më shumë se një hap përpara ose mbrapa çdo veprimtarie tjetër, do të konsiderohet veprimtari pastrimi të sipërfaqes. Kjo veprimtari nuk i referohet pastrimit të pajisjes, por pastrimit të sipërfaqes së produkteve.

Ekstraktimi i vajit vegjetal e yndyrës së kafshëve dhe veprimtaritë e rafinimit të vajit vegjetal

- Çdo veprimtari për ekstraktimin e vajit vegjetal nga farat dhe lëndë të tjera bimore, përpunimi i mbetjeve të thata për të prodhuar ushqim për kafshët, pastrimi i yndyrave dhe vajrave bimore që vijnë nga farat, lëndët bimore dhe/ose shtazore.

Lustrimi i makinave

- Çdo veprimtari lyerje industriale ose tregtare dhe aktivitetet e zgrasatimit/heqjes së yndyrës që lidhen me ato që bëjnë:

a) veshje origjinale të mjeteve rrugore, sipas përkufizimit në nenin 47, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;

b) pjesë të tyre me materiale me natyrë lustrimi, në rastin kur kjo është kryer larg linjës origjinale të prodhimit;

c) lyerjen e rimorkiove (përfshirë gjysmë-rimorkiot) (kategoria O).

Veshje e telave/bobinave

- Çdo veprimtari lyerje/veshje e përçuesve metalikë që përdoren për përdredhjen e telit në transformatorë dhe motorë etj.



Ngopja/njomja e drurit
- Çdo veprimtari që fut një sasi prezervativi në një masë druri.

Laminimi i drurit dhe plastikës

- Çdo veprimtari që ngjit drurin me drurin dhe/ose plastikën për të prodhuar produkte të laminuar

SHTOJCA IIA

PJESA 1. PRAGJET DHE KONTROLLET E SHKARKIMIT

	Veprimtaria (pragu i konsumit të tretësit në ton/për vit)	Pragu (pragu i konsumit të tretësit në ton/për vit)	Vlerat kufi të shkarkimit në mbetjet e gazta (mg C/Nm ³)	Vlerat e shkarkimit flurues (përqindja inputit të tretësve)		Vlerat kufi të shkarkimit total		Dispozita të veçanta
				E re	Ekzistuese	E re	Ekzistuese	
1	Procesi i tharjes së shpejtë të bojës së stampimit/printimit me anë të ajrit të nxehët (> 15)	15—25 > 25	100 20	30 (1) 30 (1)	 	 	 	(1) Mbetjet e tretësit në produktin e përfunduar nuk konsiderohen si pjesë e shkarkimeve fluruese.
2	Publikimi i materialeve me anë të procesit rotogravurë (> 25)		75	10	15			
3	Procese të tjera rotogravurë, fleksografi, stampimi/printimi me makinë shtypi rotativë, laminim ose lustrim (> 15) Stampim/printim me makinë shtypi rotativë mbi tekstile/karton (> 30)	15—25 > 25 > 30 (1)	100 100 100	25 20 20	 	 	 	(1) Pragu për printimin me makinë shtypi rotative mbi tekstile dhe karton.
4	Pastrimi i sipërfaqes (1) (> 1)	1—5 > 5	20 (2) 20 (2)	15 10	 	 	 	(1) duke përdorur përbërësit e përcaktuar në pikat 6 dhe 8 të kreut III. (2) Kufiri i referohet masës së përbërësve në mg/Nm ³ , dhe jo karbonit total.
5	Pastrues të tjerë të të sipërfaqes (> 2)	2—10 > 10	75 (1) 75 (1)	20 (1) 15 (1)	 	 	 	(1) Instalimet që i demonstrojnë AKM-së se përmbajtja mesatare e e tretësit organik e të gjithë materialit pastrues të përdorur nuk kalon 30 % të peshës, përjashtohen nga zbatimi i këtyre vlerave.
6	Lyerja/veshja e mjeteve (< 15) dhe lustrimi i mjeteve	> 0,5	50 (1)	25				(1) Përputhshmëria me pikën 5 të kreut VII demonstron bazuar në matjet mesatare prej 15 minutash.
7	Lyerja/veshja e bobinave (> 25)		50 (1)	5	10			(1) Për instalimet që përdorin teknikat të cilat lejojnë ripërdorimin e tretësve të rigjeneruar, kufiri i shkarkimit është 150.
8	Veprimtari të tjera të lyerjes/veshjes përfshirë metalin,	5—15 > 15	100 (1) (4) 50/75 (2) (3) (4)	25 (4) 20 (4)	 	 	 	(1) Vlera kufi e shkarkimit zbatohet mbi proceset e lyerjes/veshjes dhe tharjes që



	plastikën, tekstin (5), pëlhurat, filmin dhe letrën (> 5)						funksionojnë në kushte mbajtjeje. (2) Vlera kufi e shkarkimit të parë zbatohet në proceset e tharjes, e dyta në proceset e aplikimit të lyerjes/veshjes. (3) Për instalimet e veshjes/lyerjes së tekstileve të cilat përdorin teknikat që lejojnë ripërdorimin e tretësve të rigjeneruar, kufiri i shkarkimit të zbatuar në aplikimin e lyerjeve/veshjeve dhe proceset e tharjes të marra së bashku është 150. (4) Veprimtari veshje/lyerje të cilat nuk mund të zbatohen në kushte mbajtje (të tilla si: ndërtimi i anijeve, lyerja e avionëve) mund të përjashtohen nga këto vlera, në përputhje me dispozitat e parashikuara, në shkronjën “b” të pikës 2 të kreut III. (5) Printimi me makinë shtypi rotativë të tekstileve mbulohet nga veprimtaria numër 3.
9	Veshja e telave të bobinave (> 5)					10 g/kg (1) 5 g/kg (2)	(1) Zbatohet për instalimet kur diametri mesatar i telit është ≤ 0,1 mm. (2) Zbatohet për të gjitha instalimet e tjera.
10	Lyerja/veshja e sipërfaqeve të drurit (> 15)	15—25 > 25	100 (1) 50/75 (2)	25 20			(1) Kufiri i shkarkimit zbatohet në aplikimet e proceseve të veshjes/lyerjes dhe tharjes që funksionojnë në kushte mbajtje. (2) Vlera e parë zbatohet në proceset e tharjes, e dyta në proceset e aplikimit të lyerjes/veshjes.
11	Pastrimi kimik					20 g/kg (1) (2) (3)	(1) Shprehur në masën e tretësit të lëshuar për kilogram të produktit të pastruar dhe të tharë. (2) Kufiri i shkarkimit në pikën 8 të kreut III nuk zbatohet për këtë sektor.
12	Ngopja/njomja e drurit (> 25)		100 (1)	45		11 kg/m ³	(1) Nuk zbatohet për ngopjen/njomjen me katran.
13	Veprimtari të lyerjes/veshjes së lëkurës (> 10)	10—25 > 25 > 10 (1)				85 g/m ² 75 g/m ² 150 g/m ²	Kufijtë e shkarkimit të tretësit të lëshuar për m ² të produktit të prodhuar shprehen në gram. (1) Për veprimtaritë e lyerjes/veshjes së lëkurës dhe veçanërisht mallrat e lëkurës që përdoren si mallra të vogla për konsumatorin, të tilla si: çanta, rripa, portofola etj.
14	Prodhimi i këpucëve (> 5)					25 g për palë	Vlerat kufi të shkarkimit total shprehen në gram tretës të



							shkarkuar për çdo palë këpucë të prodhuara.
15	Laminimi i drurit dhe plastikës (> 5)					30 g/m ²	
16	Veshje me adeziv/ngjitje (> 5)	5—15	50 (1)	25			(1) Në qoftë se janë përdorur teknika që lejojnë ripërdorimin e tretësve të rigjeneruar, vlera e shkarkimit kufi në mbetjet e gazta do të jetë 150.
		> 15	50 (1)	20			
17	Prodhimi i përzierjeve veshëse, llaqeve, bojërave të printimit dhe ngjitësve (> 100)	100—1 000	150	5		5 % e inputit të tretësit	Vlera e shkarkimit të avullueshëm nuk përfshin tretësin e shitur si pjesë të një përzierje veshëse në një enë të vulosur.
		> 1 000	150	3		3 % e inputit të tretësit	
18	Shndërrimi i gomës (> 15)		20 (1)	25 (2)		25 % e inputit të tretësit	(1) Në qoftë se janë përdorur teknika që lejojnë ripërdorimin e tretësve të rigjeneruar, vlera e shkarkimit kufi në mbetjet e gazta do të jetë 150. (2) Vlerat e shkarkimit flurues nuk përfshin tretësin e shitur si pjesë e një produkti ose përzierje në një enë të vulosur.
19	Ekstraktimi i vajit vegjetal dhe yndyrës së kafshëve, si dhe veprimtaritë e rafinimit të vajit vegjetal (> 10)					Yndyrë shtazore: 1,5 kg/tonë Kastor: 3 kg/tonë bërsi rrushi: 1 kg/ton Fara lulëdielli: 1 kg/ton Kokrrat e sojës (shtypje normale): 0,8 kg/ton Kokrrat e sojës (fletë të bardha): 1,2 kg/tonë Fara të tjera dhe lëndë të tjera bimore: 3 kg/tonë (1) 1,5 kg/tonë (2) 4 kg/tonë (3)	(1) Vlerat kufi të shkarkimit total për instalimet e përpunimit të grupeve të caktuara të farave dhe lëndëve të tjera bimore vendosen nga AKM rast pas rasti, duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme. (2) zbatohet për të gjitha proceset e fraksionimit përjashtuar heqjen e ngjitësve nga vaji. (3) zbatohet për heqjen e ngjitësve.
20	Prodhimi i produkteve farmaceutike (> 50)		20 (1)	5 (2)	15 (2)	5 % e inputit të tretësit	15 % e inputit të tretësit (1) Në qoftë se përdoren teknika që lejojnë ripërdorimin e tretësve të rigjeneruar, vlera kufi e shkarkimit në mbetjet e gazta duhet të jetë 150. (2) Vlera kufi e shkarkimit flurues nuk përfshin tretësin e shitur si pjesë të produkteve ose përzierjeve në një enë të vulosur.

PJESA II. INDUSTRIA E VESHJES SË AUTOMJETEVE

Vlerat kufi të shkarkimit total shprehen në gram tretës të shkarkuar në lidhje me sipërfaqen e produktit në metra katrorë dhe në kilogramë tretës të shkarkuar në lidhje me trupin e makinës.

Sipërfaqja e çdo produkti të trajtuar në tabelën e mëposhtme përcaktohet si më poshtë:

- sipërfaqja e llogaritur nga sipërfaqja totale me veshje elektroforetike dhe sipërfaqja e çdo pjese, që mund të shtohet në fazat e mëpasme të procesit të lyerjes, të lyera me të njëjtën veshje si ajo e



përdorur për produktin në fjalë, ose sipërfaqja totale e produktit të lyer/veshur në atë instalim.

Sipërfaqja e veshjes elektroforetike llogaritet duke përdorur formulën:

$$2 \times \text{pesha totale e syprinës së produktit}$$

Trashësia mesatare e fletës së metalit x densiteti i fletës së metalit

Kjo metodë duhet të zbatohet edhe për pjesë të tjera të veshura të ndërtuara prej fletësh metalit.

Për të llogaritur sipërfaqen e pjesëve të tjera të shtuara ose sipërfaqen totale të veshur në atë instalim përdoret projektimi me kompjuter ose metoda të tjera ekuivalente.

Vlera kufi e shkarkimit total në tabelën më poshtë i referohet të gjithë fazave të procesit që kryhen në të njëjtin instalim që nga veshja elektroforetike apo çdo lloj tjetër procesi veshje, deri në lustrimin përfundimtar me dyllë deri në shtresën e sipërme, dhe tretësit që përdoret për pastrimin e pajisjeve të procesit, përfshirë kabinat e sprucimit dhe pajisje të tjera të palëvizshme, gjatë dhe jashtë kohës së prodhimit.

Vlera kufi e shkarkimit total shprehet si shumë e masës së përbërësve organikë për m² të sipërfaqes totale të produktit të veshur dhe shumës së masës të përbërësve organikë për një trup automjeti.

Veprimtaria (pragu i konsumit të tretësit në ton/ vit)	Pragu i prodhimit (referuar prodhimit vjetor të artikujve që ju aplikohet veshje)	Vlera kufi e shkarkimit total	
		E re	Ekzistuese
Veshja e makinave të reja (> 15)	> 5 000	45 g/m ² ose 1,3 kg/për trup + 33 g/ m ²	60 g/m ² ose 1,9 kg/për trup + 41 g/ m ²
	≤ 5 000 shasi integrale ose > 3 500 shasi ndërtuar prej pjesësh	90 g/m ² ose 1,5 kg/për trup + 70 g/m ²	90 g/m ² ose 1,5 kg/ për trup + 70 g/ m ²
		Kufiri i shkarkimit total (g/ m ²)	
Veshja e kabinave të kamionëve të rinj (> 15)	≤ 5 000	65	85
	> 5 000	55	75
Veshja e furgonëve dhe kamionëve të rinj (> 15)	≤ 2 500	90	120
	> 2 500	70	90
Lyerja e autobusëve të rinj (> 15)	≤ 2 000	210	290
	> 2 000	150	225

Instalimet ku realizohet veshja e automjeteve, të cilat bien nën pragjet e konsumit të tretësit të dhëna në tabelën më sipër përmbushin kërkesat për sektorin e lustrimit të automjeteve të përcaktuara në shtojcën IIA.

SHTOJCA II B

SKEMA E PAKËSIMIT TË SHKARKIMEVE

1. Parimet

Qëllimi i skemës së pakësimit është t'i krijojë operatorit mundësinë të arrijë me mjete të tjera pakësimin e shkarkimeve, ekuivalente me ato që do të arriheshin në qoftë se do të zbatoheshin vlerat kufi të shkarkimit. Për këtë qëllim operatori mund të përdorë cilëndo skemë pakësimi, të projektuar specifikisht për instalimin e tij, me kusht që në fund të arrihet një pakësim ekuivalent shkarkimi.

Progresi i bërë për arritjen e këtij pakësimi të shkarkimeve dhe eksperiencat e fituar nga zbatimi i skemës përkatëse do të pasqyrohen në raportin që referohet në pikën 1, të kreut VIII, të këtij vendimi.

2. Praktika

Në rastet e aplikimit të veshjeve, llaveve, ngjitësve ose bojës mund të përdoret skema e mëposhtme. Kur metoda e mëposhtme është e papërshtatshme AKM-ja mund të lejojë operatorin të përdorë një skemë alternative përjashtimi e cila përmbush parimet e përshkruara këtu. Projektimi i skemës merr parasysh faktet e mëposhtme:



a) Atje ku nuk janë gjetur akoma produkte zëvendësues që përmbajnë pak ose aspak tretës, operatorit i shtyhet afati për zbatimin e programeve të tij të pakësimit të shkarkimeve;

b) Pika e referencës për pakësimet e shkarkimeve duhet t'i korrespondojë sa më shumë të jetë e mundur shkarkimeve që do të rezultojnë, në qoftë se nuk do të merreshin masa për pakësimin e tyre.

Skema e mëposhtme funksionon për instalimet ku për të përcaktuar pikën e referencës për pakësimin e shkarkimeve mund të supozohet dhe përdoret përmbajtja konstante e trupave të ngurtë të produktit:

a) shkarkimi vjetor reference llogaritet si më poshtë:

- Përcaktohet masa totale e lëndës së ngurtë në sasinë e veshjes dhe/ose bojës, llakut ose ngjitësit të konsumuar në një vit. Lëndë e ngurtë janë të gjitha materialet në veshje, bojë, llak dhe ngjitës që ngurtësohet kur uji ose përbërësit organikë të avullueshëm avullojnë.

- Shkarkimet vjetore referencë llogariten duke shumëzuar sasinë e përcaktuar në pikën "a" më lart me faktorin e duhur të listuar në tabelën e mëposhtme. AKM-ja mund t'i ndryshojë këta faktorë për secilin instalim për të reflektuar rritjen e efikasitetit në përdorimin e lëndës së ngurtë të evidentuar me anë të dokumenteve.

Veprimtaria	Faktori shumëzues që duhet përdorur në pikën (ii)(b) më lart
Printimi rotogravure; printimi flexografik; laminimi si pjesë e veprimtarisë printuese; lustrimi si pjesë e veprimtarisë printuese; veshja/lyerja e drurit; veshja/lyerja e tekstileve, pëlhurave, filmit ose letres; veshja me adezive	4
Lyerja/veshja e bobinave, lustrimi i automjeteve	3
Veshja/lyerja e jashtme e ushqimeve, veshja/lyerja e pajisjeve aerospaciale	2,33
Veshje/lyerje të tjera dhe printim me ekran rrotullues	1,5

b) Shkarkimi i synuar është sa shkarkimi vjetor referencë i shumëzuar me një përqindje të barabartë me:

- (vlerën e shkarkimit flurues +15), për instalimet që bien ndërmjet pikës 6, të shtojcës IIA, dhe pragut më të ulët në krahasimin ndërmjet pikave 8 e 10, po aty;

- (vlerën e shkarkimit flurues +5) për të gjitha instalimet e tjera.

c) Përputhshmëria arrihet në qoftë se shkarkimi i tretësit ekzistues të përcaktuar nga programi i menaxhimit të tretësit është më pak ose i barabartë me shkarkimin e synuar.

SHTOJCA III

PROGRAMI I MENAXHIMIT TË TRETËSVE

Hyrje

Kjo Shtojcë jep udhëzime për hartimin e programit të menaxhimit të tretësve. Ai jep parimet që duhen zbatuar (pika 2 më poshtë), kuadrin për bilancin e masës (pika 3 më poshtë) dhe treguesin e kërkesave për verifikimin e përputhshmërisë (pika 4 më poshtë).

Parimet

Programi i menaxhimit të tretësve shërben për qëllimet e më poshtme:

verifikimin e përputhshmërisë sipas përcaktimit të pikës 1 të kreut VIII;

identifikimin e mundësive për pakësime të ardhshme;

sigurimin për publikun të informacionit mbi konsumin dhe shkarkime të tretësve dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e këtij vendimi.

Përkufizime

Përkufizimet e mëposhtme japin bazat për kryerjen e bilancit të masës.

Inputi i tretësve organikë (I):

I1 Sasia e tretësve organikë ose sasi të tyre në përzierjet e blera të cilat janë përdorur si input në një proces të caktuar në harkun kohor për të cilin llogaritet bilanci i masës.

I2 Sasia e tretësve organikë ose sasia e tyre në përzierjet e rikuperuar/rigjeneruar dhe ripërdorur në inputin e tretësve në këtë proces. (Tretësi i ricikluar llogaritet sa herë që përdoret për të kryer veprimtarinë.)



Produktet e tretësve organikë (O):

O1 Shkarkimet në mbetjet e gazta.

O2 Tretësit organikë që kanë humbur në ujë. Në qoftë se është e përshtatshme, kur llogaritet O5, merret parasysh trajtimi i ujërave të ndotur.

O3 Sasia e tretësve organikë që mbeten si ndotje ose mbetje në produktet që rezultojnë nga procesi.

O4 Shkarkimet e pakapura në ajër të tretësve organikë. Kjo përfshin ventilimin e përgjithshëm të dhomave, ku ajri çlirohet në mjedisin e jashtëm nëpërmjet dritareve, dyerve, ventilatorëve dhe të çarave të ngjashme.

O5 Tretësit organikë dhe/ose përbërësit organikë që kanë humbur gjatë reaksioneve kimike ose fizike (përfshirë për shembull ato që janë shkatërruar, p.sh., nga incinerimi, në mbetjet e tjera të gazta, gjatë trajtimit të ujërave të ndotur apo ato që janë kapur, p.sh., përmes adsorbimit për sa kohë ato nuk llogariten sipas O6, O7 ose O8).

O6 Tretësit organikë që ndodhen në mbetjet e grumbulluara.

O7 Tretësit organikë ose tretësit organikë që gjenden në përzierjet që shiten ose synohet të shiten në treg si produkte.

O8 Tretësit organikë që gjenden në përzierjet e rikuperuara/rigjeneruara për ripërdorim por jo si input në proces, për sa kohë që nuk llogariten sipas O7.

O9 Tretësit organikë të shkarkuar në rrugë të tjera.

Udhëzim për përdorimin e programit të menaxhimit të tretësve për verifikimin e përputhshmërisë

Përdorimi i programit të menaxhimit të tretësit përcaktohet nga kërkesa e veçantë që duhet verifikuar, si më poshtë:

Verifikimi i përputhshmërisë me opsionin e pakësimit të shkarkimeve që jepet në shtojcën IIB, me vlerën kufi të shkarkimit total të shprehur si shkarkim i tretësve për njësi produkti ose siç thuhet ndryshe në shtojcën IIA.

Për të gjitha veprimtaritë që përdorin skemën e pakësimit të shkarkimeve sipas shtojcës IIB, për të përcaktuar konsumin (C) programi i menaxhimit duhet të hartohet çdo vit. Konsumi mund të llogaritet sipas ekuacionit: $C = I1 - O8$.

Gjithashtu, për të nxjerrë shkarkimin vjetor referencë dhe shkarkimin e synuar për çdo vit, paralelisht me sa më lart duhet të përcaktohet lënda e ngurtë që përdoret në veshje/lyerje.

Për vlerësimin e përputhshmërisë me vlerën kufi të shkarkimit total të shprehur në shkarkimet e tretësve për njësi produkti ose siç shprehet ndryshe në Shtojcën IIA, programi i menaxhimit të tretësve për përcaktimin e shkarkimeve (E) duhet të bëhet çdo vit. Shkarkimet mund të llogariten sipas ekuacionit: $E = F + O1$

Ku F është shkarkim fluruese sipas përcaktimit në seksionin (ii) (a). Shifra e shkarkimit duhet më pas të pjesëtohet nga parametri i produktit përkatës.

Për vlerësimin e përputhshmërisë me kërkesat e germës “b” (ii) të pikës 5 të kreut IV, për të përcaktuar shkarkimet totale nga të gjitha veprimtaritë në fjalë programi i menaxhimit të tretësve duhet të hartohet çdo vit. Kjo shifër duhet më pas të krahasohet me shkarkimet totale që mund të rezultojnë në qoftë se kërkesat e shtojcës II do të ishin plotësuar për secilën veprimtari më vete.

Përcaktimi i shkarkimeve fluruese për krahasimin me vlerat e shkarkimeve fluruese në shtojcën IIA:

Metodologjia

Shkarkimet fluruese mund të llogariten sipas ekuacionit:

$$F = I1 - O1 - O5 - O6 - O7 - O8$$

Ose

$$F = O2 + O3 + O4 + O9$$

Kjo sasi mund të përcaktohet nga matja e drejtpërdrejtë e sasive. Një llogaritje e ngjashme mund të bëhet me mjete të tjera, për shembull duke përdorur eficiencën e kapjes së këtyre shkarkimeve nga ky proces.

Vlera e shkarkimeve fluruese është shprehur si proporcion i inputit, që mund të llogaritet sipas ekuacionit:

$$I = I1 + I2$$

Shpeshësia

Përcaktimi i shkarkimeve fluruese mund të bëhet nga një grup matjesh të shkurtra por gjithëpërfshirëse dhe nuk ka nevojë të bëhet përsëri derisa pajisja të modifikohet.

SHTOJCA IV MONITORIMI I SHKARKIMEVE

Kanalet në të cilat pajisja e zvogëlimit të shkarkimeve të gazeve është e lidhur, dhe që në pikën e fundit të shkarkimit lëshon më shumë se



një mesatare prej 10 kg/h të karbonit organik total, do të monitorohet vazhdimisht për përputhshmëri.

Në rastet e tjera, AKM-ja do të sigurojë që të kryhen matje të vazhdueshme ose matje periodike. Për matjet periodike do të merren, të paktën, tre nga vlerat e matjeve gjatë çdo ushtrimi të matjes.

Matjet nuk janë të nevojshme të kryhen në rastin kur pajisja fundore e zvogëlimit të shkarkimeve nuk është e nevojshme të jetë në përputhje me këtë vendim.

VENDIM

Nr. 909, datë 21.12.2016

PËR RIKUPERIMIN E AVUJVE TË BENZINËS NË FAZËN E DYTË, GJATË MBUSHJES SË MJETEVE MOTORIKE NË STACIONET E SHITJES SË KARBURANTEVE³

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “ç”, të nenit 15, të ligjit nr.162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë masat për reduktimin e sasisë së avullit të benzinës të lëshuar në atmosferë gjatë mbushjes së mjeteve motorike në stacionet e shitjes së karburanteve.

2. Ky vendim zbatohet për të gjitha stacionet e shitjes së karburanteve.

3. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Avulli i benzinës”, çdo përbërës i gaztë, që avullon nga benzina;

b) “Benzinë”, benzina, sipas përcaktimit në vendimin nr. 1075, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për masat për kontrollin e

shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC), që rezultojnë nga magazinimi dhe shpërndarja e benzinës nga терминалет në stacionet e shitjes së karburanteve”;

c) “Eficienca e kapjes së avujve të benzinës”, vlera e shprehur në përqindje e raportit të sasisë së avujve të benzinës, të kapur nga faza II e sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës, e krahasuar me sasinë e avujve të benzinës që, përndryshe, do të ishte lëshuar në atmosferë, në mungesë të një sistemi të tillë;

ç) “Sistem i rikuperimit të avujve të benzinës gjatë fazës II të mbushjes së mjetit motorik”, pajisja që ka si qëllim rikuperimin e avujve të benzinës, të zhvendosur nga depozita e karburantit të mjetit motorik gjatë mbushjes në stacionin e shitjes së karburanteve, e cila i transferon ato në depozitën e magazinimit në stacionin e shitjes së karburantit ose e kthen në automatin shpërndarës të benzinës për t’u rishitur;

d) “Organ i miratuar i vlerësimit të konformitetit”, ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar”;

dh) “Raporti avull/benzinë”, raporti ndërmjet vëllimit në presion atmosferik të avujve të benzinës, që kalon nëpërmjet sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës gjatë fazës II të mbushjes së mjetit motorik dhe vëllimit të benzinës të shpërndarë;

e) “Rendiment”, sasia totale vjetore e benzinës së shkarkuar nga kontejnerët e lëvizshëm në stacionin e shitjes së karburanteve;

ë) “Stacion shitjeje karburanti”, stacioni i shitjes së karburanteve sipas përcaktimit në vendimin nr. 1075, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për masat për kontrollin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) që rezultojnë nga magazinimi dhe shpërndarja e benzinës nga терминалет në stacionet e shitjes së karburanteve”;

f) “Stacion ekzistues për shitje karburantesh”, stacioni i shitjes së karburantit që është vënë në funksionim përpara datës 1 janar 2019;

g) “Stacion i ri për shitje karburantesh”, stacioni i shitjes së karburanteve që është vënë në funksionim pas datës 1 janar 2019.

³ Ky vendim përafron direktivën 2009/126/EC mbi fazën II të rigjenerimit të avullit të benzinës gjatë mbushjes së mjeteve motorike në pikat e shitjes, amenduar nga direktiva nr. 2014/99/EU. Numri CELEX 32009L0126. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.285, datë 31.10.2009 f. 0036–0039.



KREU II STACIONET E SHITJES SË KARBURANTEVE

1. Operatori ekonomik i çdo stacioni të ri për shitjen e karburanteve e pajis atë me sistemin e rikuperimit të avujve të benzinës gjatë fazës II të mbushjes së mjetit motorik, në qoftë se rendimenti i tij aktual ose i synuar është më i madh se:

- a) 500 m³/në vit;
- b) 100 m³/në vit dhe është vendosur në zona të banuara të përhershme/të përkohshme.

2. Operatori ekonomik i çdo stacioni ekzistues për shitjen e karburanteve, që i nënshtrohet një rinovimi të konsiderueshëm, e pajis atë me sistemin e rikuperimit të avujve të benzinës gjatë fazës II të mbushjes së mjetit motorik gjatë kohës së rinovimit, në qoftë se rendimenti i tij aktual ose i synuar është më i madh se:

- a) 500 m³/në vit;
- b) 100 m³/në vit dhe është vendosur në zona të banuara të përhershme/të përkohshme.

3. Operatori ekonomik i çdo stacioni ekzistues për shitjen e karburanteve me rendiment mbi 3000 m³/në vit e pajis atë me sistemin e rikuperimit të avujve të benzinës gjatë fazës II të mbushjes së mjetit motorik jo më vonë se data 31 dhjetor 2026.

4. Dispozitat e parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij kreu, nuk zbatohen për stacionet e shitjes të karburanteve që përdoren ekskluzivisht si shoqëruese të ndërtimit dhe të shpërndarjes së mjeteve të reja motorike.

5. Operatori ekonomik i stacionit të shitjes së karburanteve instalon një sistem monitorimi automatik, për të zbuluar automatikisht defektet e funksionimit të sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës gjatë fazës II të mbushjes së mjetit motorik dhe të vetë sistemit të monitorimit automatik. Sistemi i monitorimit automatik i tregon operatorit ekonomik defektet në stacionet e shitjes së karburanteve dhe ndalon, automatikisht, rrjedhjen e benzinës nga shpërndarësi që ka defekt, në qoftë se defekti nuk zbuluar brenda 7 ditëve.

KREU III NIVELI MINIMAL I RIKUPERIMIT TË AVUJVE TË BENZINËS

1. Nga data 31 dhjetor 2026, e përcaktuar në kreun II, për fillimin e zbatimit të sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës gjatë fazës II të

mbushjes së mjetit motorik, efienca e kapjes së avujve të benzinës e sistemeve të tilla duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se 85%, sipas certifikimit nga fabrikuesi, në përputhje me standardin EN 16321-1:2013.

2. Nga data 31 dhjetor 2026, e përcaktuar në kreun II, për fillimin e zbatimit të sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës gjatë fazës II të mbushjes së mjetit motorik, kur avujt e rikuperuar të benzinës transferohen në depozitën e magazinimit në stacionin e shitjes së karburanteve, raporti avull/benzinë duhet të jetë i barabartë ose më i madh se 0,95 dhe më i vogël ose i barabartë me 1,05.

KREU IV INSPEKTIMET PERIODIKE

1. Operatori ekonomik ia nënshtrohet sistemin e rikuperimit të avujve të benzinës gjatë fazës II të mbushjes së mjetit motorik një organi të miratuar sipas procedurave të ligjit nr. 10489/2011 dhe në përputhje me standardin S SH EN 16321-1:2013;

2. Operatori ekonomik ia nënshtrohet testimin e sistemit automatik të monitorimit një organi të miratuar të vlerësimit të konformitetit, të paktën një herë në çdo 3 vjet.

3. Operatorët ekonomikë kryejnë kontrolle periodike, në lidhje me nivelin e shkarkimeve në ajër të avujve të benzinës, të cilët janë objekt inspektimi nga ana e inspektoratit përgjegjës për mjedisin.

4. Operatorët ekonomikë kryejnë kontrolle periodike të sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës gjatë fazës II të mbushjes së mjetit motorik dhe të sistemit automatik të monitorimit, të cilët janë objekt inspektimi nga ana e inspektoratit përgjegjës për industrinë.

5. Inspektimi periodik dhe, sipas rastit, joperiodik i sistemeve të rikuperimit dhe të sistemeve automatike të monitorimit kryet nga organet e vlerësimit të konformitetit, të miratuara nga ministri përgjegjës për industrinë.

6. Kur operatori ekonomik i stacionit të shitjes së karburanteve instalon sistemin e rikuperimit të avujve të benzinës gjatë fazës II të mbushjes së mjetit motorik, ai vendos një shenjë, shpallje apo njoftim tjetër mbi shpërndarësin e benzinës ose në afërsi të tij, për të informuar konsumatorin për këtë fakt.



7. Për mospërputhshmëri me kërkesat e këtij vendimi, inspektorati përgjegjës për mjedisin zbaton kërkesat e pikës 1, të nenit 20, të ligjit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis.

KREU V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, inspektorati përgjegjës për mjedisin dhe inspektorati përgjegjës për industrinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet juridike me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM Nr. 910, datë 21.12.2016

PËR ÇËSHTJET, OBJEKT KONSULTIMI, DHE STRUKTURËN, PROCEDURËN, FORMËN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KONSULTATIV TË QEVERISJES QENDRORE ME VETËQEVERISJEN VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të tretë, të nenit 12, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I QËLLIMI DHE NATYRA E ÇËSHTJEVE PËR KONSULTIM

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, përbërjen dhe funksionimin e tij, natyrën e çështjeve, objekt konsultimi, dhe procesin e konsultimit mes qeverisjes vendore dhe qeverisjes qendrore. Kuptimi i njërive të vetëqeverisjes vendore përcaktohet në nenin 5, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

2. Objekt i konsultimit mes qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, sipas këtij vendimi, janë edhe funksionet dhe/ose kompetencat e deleguara pushtetit vendor, transferimi i funksioneve ose kompetencave të reja dhe propozimet e politikave për çështje që prekin interesat e pushtetit vendor, në përputhje me legjislacionin përkatës.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore konsultohen gjatë vitit kalendarik për financat e tyre, mjaftueshmërinë dhe stabilitetin e burimeve të tyre për arritjen e qëllimeve dhe kryerjen e shërbimeve të përcaktuara për to në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe ligjet e tjera në fuqi.

4. Çështjet, të cilat janë objekt konsultimi mes qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, sipas këtij vendimi, janë:

a) hartimi dhe zbatimi i politikave të decentralizimit dhe monitorimi i realizimit të tyre;

b) hartimi dhe zbatimi i politikave fiskale dhe financiare vendore, përfshirë transfertat ndërqeveritare dhe financimi i qeverisjes vendore nga buxheti i shtetit;

c) funksionet e bashkive në fushat e mëposhtme:

i) infrastrukturë dhe shërbimet publike;

ii) shërbimet sociale;

iii) arsim, kulturë, sport dhe shërbime argëtuese;

iv) mbrojtjen e mjedisit;

v) bujqësi dhe zhvillim rural, pyje e kullota, natyrë dhe biodiversitet, si dhe administrim të burimeve ujore;

vi) zhvillim ekonomik e vendor;

vii) siguri publike;

viii) mbrojtjen e konsumatorëve;

ç) hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale;

d) hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat shtetërore në nivel qarku;

dh) funksionet dhe kompetencat e këshillit të qarkut dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj;

e) nxitja e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkufitar, me objekt zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të zonave ndërkufitare;

ë) çdo çështje tjetër që është në interesin e ndërsjellë të qeverisjes qendrore dhe/ose qeverisjes vendore.



KREU II

PARIMET E PROCESIT TË KONSULTIMIT

5. Procesi i konsultimit në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore bazohet në:

a) parimin e informimit, nëpërmjet njoftimit dhe vënies në dispozicion të anëtarëve të Këshillit Konsultativ, shoqatave përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe, nëpërmjet tyre, të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore të projektligjeve, projektvendimeve, projektpolitikave ose projektstrategjive që propozohen nga qeverisja qendrore;

b) parimin e konsultimit, nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve për projektligjet, projektaktet nënligjore, projektpolitikat ose projektstrategjitë të propozuara nga qeverisja qendrore dhe që kanë ndikim në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore;

c) parimin e angazhimit të shoqatave përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe të vetë këtyre njësive, si dhe rritjen e transparencës, nëpërmjet përfshirjes së tyre në procesin e formulimit e të miratimit të projektakteve, politikave dhe zgjidhjeve konkrete;

ç) parimin e bashkëpunimit dhe dialogut konstruktiv me të gjitha shoqatat përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore.

KREU III

KRIJIMI, PËRBËRJA DHE DREJTIMI I
KËSHILLIT KONSULTATIV TË
QEVERISJES QENDRORE ME
VETËQEVERISJEN VENDORE

6. Me qëllim arritjen dhe institucionalizimin e procesit të konsultimit mes qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore krijohet Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, i cili është forumi kryesor ku qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projektpolitikat dhe projektstrategjitë që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

7. Përbërja e Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore është në përfaqësim të barabartë anëtarësh, 9 përfaqësues të

qeverisjes qendrore dhe 9 përfaqësues të vetëqeverisjes vendore, si më poshtë vijon:

- ministri përgjegjës për çështjet vendore;
- zëvendësministri përgjegjës për fushën e financave;
- zëvendësministri përgjegjës për çështjet e brendshme;
- zëvendësministri përgjegjës për planifikimin dhe zhvillimin urban;
- zëvendësministri përgjegjës për çështjet e transportit dhe infrastrukturës;
- zëvendësministri përgjegjës për çështjet sociale;
- zëvendësministri përgjegjës për integrimin evropian;
- zëvendësministri përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural;
- zëvendësministri përgjegjës për mjedisin;

Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore dhe 2 kryetarë bashkie, përfaqësues të Shoqatës për Autonomi Vendore;

Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe 2 kryetarë bashkie, përfaqësues të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë;

Kryetari i Shoqatës së Qarqeve dhe 2 kryetarë qarku, përfaqësues të Shoqatës së Qarqeve.

Anëtarët që përfaqësojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore caktohen me vendim të vetë shoqatave dhe duhet që sa më shumë të jetë e mundur të pasqyrojnë shumëllojshmërinë e njësive vendore në Shqipëri, në kuptim të numrit të popullsisë dhe të gjeografisë. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sigurimit të një përfaqësimi të balancuar gjinor, siç parashikohet në legjislacionin e brendshëm.

8. Në mbledhjet e Këshillit Konsultativ mund të ftohen të marrin pjesë kryesia e Komisionit Përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë, kryetari i Nënkomisionit të Përhershëm Parlamentar për Qeverisjen Vendore, anëtarë të tjerë të Këshillit të Ministrave apo përfaqësues të tyre, përfaqësues të sektorit të kontrollit të ndihmës shtetërore pranë ministrisë përgjegjëse të ekonomisë, përfaqësues të organizmave dhe programeve ndërkombëtare me fokus veprimtarinë e qeverisjes vendore, si dhe drejtues të institucioneve kushtetuese ose institucioneve të tjera qendrore që kanë lidhje me çështjet, objekt konsultimi.



9. Mbledhjet e Këshillit Konsultativ bashkëdrejtohen nga ministri përgjegjës për çështjet vendore dhe një nga drejtuesit e shoqatave përfaqësuese të pushtetit vendor. Drejtuesit e shoqatave përfaqësuese të pushtetit vendor drejtojnë Këshillin Konsultativ mbi bazën e rotacionit, për një vit kalendarik, duke filluar nga shoqata përfaqësuese me numrin më të madh të anëtarëve.

10. Në veçanti, mbledhjet e Këshillit Konsultativ për çështjet e financave vendore, sipas shkronjës “b”, të pikës 4, bashkëkryesohen nga ministri i Financave dhe/ose zëvendësministri i Financave me delegim të ministrit të Financave dhe në të përveç anëtarëve të përhershëm të këshillit marrin pjesë edhe përfaqësues të tjerë nga stafi teknik i Ministrisë së Financave. Ministria e Financave luan rolin e sekretariatit teknik për çështjet e financave vendore.

11. Mbledhjet e Këshillit Konsultativ si rregull zhvillohen të hapura. Në raste të veçanta, mbledhjet e këshillit mund të zhvillohen edhe të mbyllura, kur për këtë bien dakord dy bashkëkryetarët.

KREU IV

PROCEDURA E KONSULTIMIT TË AKTEVE DHE MBLEDHJET E KËSHILLIT

12. Projekligjet, projektvendimet, projektpolitikat ose projektstrategjitë, që lidhen me fushën e funksioneve të vetëqeverisjes vendore sipas neneve 12, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34-43, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe çdo projektakt tjetër që përfshihet në fushën e veprimit të këtij vendimi, i dërgohen në formë elektronike e të shkruar Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ prej sekretarëve të përgjithshëm të institucioneve propozuese të projektaktit.

13. Me marrjen e tyre, Sekretariati Teknik i shfaq ato brenda tri ditësh pune në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Konsultativ dhe në formë elektronike e të shkruar ia dërgon çdo anëtar të Këshillit Konsultativ.

14. Afati brenda të cilit anëtarët e Këshillit Konsultativ dhe njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore mund të paraqesin vërejtjet, mendimet, komentet dhe propozimet e tyre, është 15 ditë kalendarike nga e nesërmyja e dërgimit të projektaktit anëtarëve të Këshillit Konsultativ.

15. Në përfundim të këtij afati, brenda 7 ditësh, Sekretariati Teknik organizon punën për përgatitjen e përmbledhjes sipas mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve të paraqitura dhe ia dërgon ato propozuesit të projektaktit dhe anëtarëve të Këshillit Konsultativ. Një kopje e tyre shfaqet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Konsultativ.

16. Institucioni propozues nuk vijon procedurën e miratimit të projektaktit deri në marrjen e komenteve, mendimeve, vërejtjeve dhe propozimeve nga Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ ose mbarimit të afatit për paraqitjen e tyre.

17. Këshilli Konsultativ zhvillon aktivitetin e tij nëpërmjet:

a) konsultimit dhe komunikimit *on-line*, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim;

b) mbledhjeve të punës;

c) mbledhjeve plenare.

18. Bashkëkryetarët e Këshillit Konsultativ kujdesen për organizimin dhe funksionimin e Këshillit dhe kryerjen e detyrave të tij sipas këtij vendimi. Rendi i ditës së mbledhjes së Këshillit Konsultativ dhe materialet shoqëruese të tyre bëhen kurdoherë publike në faqen e internetit të Këshillit.

19. Në bashkëpunim me Sekretariatit Teknik, bashkëkryetarët e Këshillit Konsultativ mund të thërrasin mbledhje pune të tij, e cila zhvillohet jo më herët se 7 ditë nga data e marrjes së njoftimit të mbledhjes nga anëtarët e Këshillit.

20. Bashkëkryetarët e Këshillit Konsultativ janë të detyruar të thërrasin mbledhjen e Këshillit në rast se jo më pak se 8 anëtarë të tij e kërkojnë me shkrim këtë gjë. Kërkesit duhet të paraqesin në këtë rast rendin e ditës dhe materialet shoqëruese të tij. Mbledhja e punës zhvillohet jo më herët se 7 ditë nga data e depozitimit të kërkesës për thirrjen e mbledhjes.

21. Mbledhjet plenare të Këshillit Konsultativ zhvillohen në muajin mars dhe muajin tetor të çdo viti kalendarik. Rendi i ditës së mbledhjes plenare të Këshillit Konsultativ përcaktohet nga ministri përgjegjës për çështjet vendore në bashkëpunim me shoqatat përfaqësuese të njërive të vetëqeverisjes vendore.

22. Rendi i ditës së mbledhjes plenare të muajit tetor si rregull është vetëm për projektligjin e buxhetit të shtetit dhe projektligjet financiare që



lidhen drejtpërdrejt me buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore.

23. Me vendim të bashkëkryetarëve të Këshillit Konsultativ ose me vendim të Këshillit Konsultativ mund të krijohen komisione këshillimi, si struktura ad hoc për të mbuluar fusha dhe sektorë specifikë. Komisionet e këshillimit janë të përkohshme dhe përfundojnë funksionimin e tyre me kryerjen e detyrave që u janë ngarkuar. Në aktin e krijimit të komisioneve të këshillimit përcaktohen kryesuesi i tij dhe detyrat e ngarkuara.

24. Në mbledhjet e punës dhe mbledhjet plenare të Këshillit Konsultativ vendimet merren me konsensus. Në përfundim të mbledhjeve, Këshilli Konsultativ mund të miratojë rekomandime konkrete drejtuar institucioneve të qeverisjes qendrore apo institucioneve të tjera publike. Në rastet kur nuk arrihet konsensusi, mendimet e përfaqësuesve të njësive të vetëqeverisjes vendore, në mbështetje ose jo të projekteve të propozuara të qeverisjes qendrore, i bashkëlidhen praktikës dokumentare që shoqëron procesin vijues të vendimmarrjes përkatëse në Këshillin e Ministrave ose në Kuvend.

25. Projektaktet që propozohen për miratim duhet të përshkruajnë zbatimin e procedurës së konsultimit sipas këtij vendimi dhe arsyet e mosreflektimit të vërejtjeve të paraqitura në përfundim të këtij konsultimi.

KREU V SEKRETARIATI TEKNIK

26. Pranë Këshillit Konsultativ funksionon Sekretariati Teknik që kryen funksione ndihmëse dhe administrative. Rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ e kryen Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale. Për kryerjen e funksioneve të sekretariatit teknik, AZRT-ja mund të mbështetet edhe nga donacione e ndryshme, si dhe nga çdo burim tjetër i ligjshëm.

27. Sekretariati Teknik kryen këto detyra:

a) Administron faqen zyrtare të internetit të Këshillit Konsultativ dhe përcakton rregullat e aksesit në këtë faqe;

b) Grumbullon dhe përpunon komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e anëtarëve të Këshillit Konsultativ dhe njësive të tjera të vetëqeverisjes vendore në procesin e konsultimit;

c) U dërgon anëtarëve të Këshillit Konsultativ, Këshillit të Ministrave, ministrive përkatëse ose

institucioneve të tjera shtetërore informacionin e përpunuar dhe dokumentacionin shoqërues;

c) Monitoron dhe zbaton rekomandimet e Këshillit Konsultativ;

d) Ndihmon dhe mbështet Këshillin Konsultativ në punën dhe mbarëvajtjen e takimeve;

dh) Me kërkesë të bashkëkryetarëve ose të Këshillit Konsultativ përgatit raporte dhe studime për çështje që lidhen me fushën e veprimtarisë së Këshillit;

e) Kujdeset për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të punës dhe mbledhjeve plenare të Këshillit Konsultativ dhe i publikon ato në faqen e internetit;

ë) Përgatit informacion periodik për veprimtarinë e Këshillit Konsultativ;

f) Është përgjegjës për kryerjen e njoftimeve për anëtarët e Këshillit Konsultativ;

g) Me propozim të Këshillit Konsultativ, njofton dhe merr miratimin paraprak të çdo financimi me fonde publike apo lehtësi tjetër e dhënë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë, në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore, përpara se skemat e ndihmës shtetërore të vihen në zbatim;

gj) Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Këshilli Konsultativ ose në këtë vendim.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

29. Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore miraton me konsensus rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**VENDIM****Nr. 911, datë 21.12.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË NË
SISTEMIN E MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE SPITALIN
USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR,
NË SISTEMIN E MINISTRISË SË
MBROJTJES, TË PUNONJËSVE TË
INFERMIERISTIKËS NË SISTEMIN E
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË E
MINISTRISË SË MBROJTJES, SI DHE
PËR TRAJTIMIN E MJEKËVE NË
STRUKTURAT E FORCAVE TË
ARMATOSURA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 147/2014, “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Lidhja nr. 1 (kreu 1.8), e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen nr. 1 (kreu 1.8), që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lidhja nr. 2 (kreu 2.7), e përmendur në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen nr. 2 (kreu 2.7), që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Pas pikës 18 shtohet pika 19, me këtë përmbajtje:

“19. Trajnimi i personelit mjekësor, personelit paramedikal dhe publikut të gjerë kryhet nëpërmjet veprimtarive të trajnimit që organizohen nga vetë Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore ose/dhe në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë apo qendrat spitalore.

Në rastet kur punonjësit e personelit mjekësor (me arsim të lartë) të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore marrin pjesë në veprimtaritë e trajnimit (si për personelin mjekësor ashtu edhe për personelin paramedikal dhe publikun e gjerë), të cilat organizohen nga vetë qendra, për çdo orë mësimi 60-minutëshe përfitojnë trajtim me pagesë, si më poshtë vijon:

a) Trajnerët me më pak se 10 (dhjetë) vite punë në profesion përfitojnë një pagesë 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) lekë për orë;

b) Trajnerët me më shumë se 10 vite punë në profesion përfitojnë një pagesë 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë për orë.

Trajnerët të cilët janë punonjës të personelit mjekësor (me arsim të lartë) të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore e përfitojnë këtë pagesë deri në 200 (dyqind) orë në vit.

Në rastet kur trajnerët janë bashkëpunëtorë të jashtëm nga Universiteti i Mjekësisë apo nga qendrat spitalore, pagesa për orë do të jetë e njëjtë me trajnerët e brendshëm të qendrës.”.

4. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë, për Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2017.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



Lidhja I (kreu 1.8)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN KOMBËTARE TË
URGJENCËS MJEKËSORE**

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor i përgjithshëm.	14000	2%		107800		Nga..deri ...lekë
2	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm	14000	2%		91700		Nga..deri ...lekë
3	Drejtor drejtorie	14000	2%		74400		Nga..deri ...lekë
	Përgjegjës sektori	14000	2%		65200		
4	Specialist (mjek)	14000	2%		48200	2000	Nga..deri ...lekë
5	Specialist	14000	2%		45800		Nga..deri ...lekë

Lidhja 2 (kreu 2.7)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË QENDRËN KOMBËTARE TË URGJENCËS
MJEKËSORE**

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermier urgjence		2%	0	34000	2000	Nga..deri ...lekë
2.	Infermier urgjence		2%	0	32000	2000	Nga..deri ...lekë

VENDIM**Nr. 912, datë 21.12.2016**

**PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR DOM ERNEST
SIMONI TROSHANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror Dom Ernest Simoni Troshani, në masën

e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

**VENDIM****Nr. 913, datë 21.12.2016****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR ZNJ. EDITH
MIHALI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror znj. Edith Mihali, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 914, datë 21.12.2016****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. LULZIM
BALLA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Lulzim Balla, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 915, datë 21.12.2016****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. LIONEL
KONOMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Lionel Konomi, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 916, datë 21.12.2016****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. ENVER
SHENGJERGJI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Enver Shengjergji, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**VENDIM****Nr. 917, datë 21.12.2016****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. ZEF DEDA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Zef Deda, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 918, datë 21.12.2016****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. KUJTIM
GJONAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Kujtim Gjonaj, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 919, datë 21.12.2016****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. ÇAPAJEV
GJOKUTAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Çapajev Gjokutaj, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 920, datë 21.12.2016****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. SABAH BIZI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Sabah Bizi, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**VENDIM****Nr. 921, datë 21.12.2016****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. RAMADAN
RRAGAMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Ramadan Rragami, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 922, datë 21.12.2016****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. PAULIN
NDOJA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Paulin Ndoja, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 923, datë 21.12.2016****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI
TË POSAÇËM SHTETËROR
Z. ILIR PERNASKA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Ilir Pernaska, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 924, datë 21.12.2016****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI
TË POSAÇËM SHTETËROR
Z. ALFRED SERREQI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Alfred Serreqi, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**KËRKESË****Nr. 6195, datë 21.12.2016****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën “Për shpronësim për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ura e Matit (shtesa)”, për pasuritë e llojit “drufrutorë”.

Subjekti kërkues, i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i

këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “drufrutorë”. Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 121 680 (njëqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Bahri Shaqiri**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“URA E MATIT (SHTESA)”**

Pronari				Z. Kad.	Nr. i pasurisë	Sip. e shpronësuar	Drufrutorë vlera (lekë)	Vlera totale (lekë)	Konfirmimi
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri						
1.	Zylyftar	Ismail	Lezaj	3882	466/18	657	111920	111920	Sipas vlerësimeve të DBP-së
2.	Kapllan	Ramadan	Lezaj	3882	466/14	120	9760	9760	Sipas vlerësimeve të DBP-së
SHUMA								121680	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 420 lekë